

## E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE

2002

### Në këtë numër:

#### Opinione për Politikat Ligjore

- Financat publike dhe mbikëqyrja e tyre prej publikut.
- Zhvillimet e sigurimeve shoqërore.
- Të ardhurat tatimore dhe transparenca ndaj publikut.

#### E Drejta Kushtetuese

- E Drejta Kushtetuese për informim
  - Komiza Kushtetuese për vetëqeverisjen në Kosovë.
- Integrimi Evropian:  
Pse, çfarë dhe si?

9

Botim i Qendrës së Studimeve  
Parlamentare



## TABLE OF CONTENTS

---

9<sup>th</sup> Issue, year 2002

	Page
<hr/>	
Opinions about legal policies:	
Public finances and public stakeout	
	Dr. Ylli BUFI
	4
The development of social insurances and the necessity for changes	
	Naim HASA
	10
Duty incomes and the transparency toward the public regarding their administration and usage	
	Dr. Sefedin GURI
	22
<hr/>	
Constitutional Law:	
The Constitutional Right for Information	
	Andrea LAKO
	28
Constitutional Framework for the temporary Self-governance in Kosova	
	Prof. Dr. Arsim BAJRAMI
	36
<hr/>	
Information on Laws passed by the Assembly	
	Filip LAKO
	46
<hr/>	
Information on International Assemblies' Activities:	
European Integration: Why, What and How?	
	David LANDSMAN
	55
Inter-parliamentary Cooperation in the framework of Stability Pact	
	Elira ZAKA
	65
<hr/>	
Summary in English:	
Information on Laws passed by the Assembly	
	70
<hr/>	

*Kjo rubrikë synon prezantimin e politikave ligjore dhe trajtimeve teorike per organizmin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut ne zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe mendimeve të studjuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanëshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.*

*Në këtë numër janë përzgjedhur disa çështje ligjore që paraqesin një interes të veçantë për publikun e gjerë.*

## Financat publike dhe mbikëqyrja e tyre prej publikut

*Dr. Ylli Bufi*

*Kryetar i Komisionit të Përhershëm të Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit*

Në repertorin klasik të diskutimit social-politik, tema e obligimeve civile ka një vend të veçantë. Të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, nga njëra anë dhe fuqia dhe prerogativat e shtetit nga ana tjetër, kanë formuar tradicionalisht bazën e debatit mbi atë se si mund të qeveriset më mirë shoqëria. Në fund të shekullit XIX ky debat filloi të zgjerohej me futjen e koncepteve të reja të të ashtuquajturit “*welfare state*”. Ky zgjeri thellësisht tematikën e obligimeve shtetërore në përgjithësi. Gjithashtu, në përgjithësi shteti filloi të merrte një rol më të madh edhe në ekonominë vendeve në zhvillim, madje edhe në shumicën e vendeve perëndimore. Kjo situatë filloi të ndryshonte nga fillimi i viteve 80-të me rritjen e popullaritetit të teorive neoklasike në ekonomi, që u manifestuan fillimisht me reformat e Thatcher-it dhe Reagan-it, të cilat synuan uljen e rolit të shtetit në ekonomi dhe uljen e shpenzimeve publike. Vala e këtyre ndryshimeve, të cilat vijuan dhe morën hov sidomos pas përfundimit të luftës së ftohtë, përfshiu pak a shumë të gjitha vendet. Gradualisht filluan të përpunoheshin edhe koncepte të reja për menaxhimin e shpenzimeve publike, në mënyrë që të administroheshin me racionalisht fondet e pakësuara. Sidoqoftë, shpenzimet publike, megjithë reduktimet, vazhdojnë të zënë një rol të rëndësishëm në raport me GDP-në dhe menaxhimi i tyre vazhdon të jetë pika kyçe e matjes së performancës së qeverisjes.

Që nënshtetasit ta besojnë qeverinë, ata duhet të jenë konfidentë, se burimet publike përdoren me efektivitet dhe në përputhje me nevojat dhe

interesat e nënshtetasve, të cilët janë financuesit e drejtpërdrejtë nëpërmjet sistemit të taksave. Kjo e drejtë morale dhe legjislative, burim nga kushtetutat, që të ushtrohet, kërkon edhe mekanizmat e nevojshëm administrativë, në mënyrë që qeveria të jetë e përgjegjshme në këtë aspekt para nënshtetasve të saj. Ky koncept i përgjegjshmërisë së qeverisë në administrimin e taksave të nënshtetasve, i ashtuquajtur *akauntabilitet i qeverisë*, ka pësuar një revolucion që prej fillimit të viteve 90-të. Koncepti i ri i *akauntabilitetit të qeverisë* ka zënë gradualisht vend në literaturën dhe praktikën e administrimit publik. Ky koncept i ri e bën qeverinë përgjegjëse jo vetëm për veprimet e saj, por, gjithashtu, për rezultatet e këtyre veprimeve. Predominanca dhe pranimi i këtij koncepti u konfirmua edhe në Simpoziumin e Parë mbi të Ardhmen e Shërbimeve Publike të OECD-së në mars të vitit 1996. Baza teorike e këtij koncepti mbështetet mbi tri parime të thjeshta, të cilat përcaktojnë se *akauntabiliteti i qeverisë* ndaj qytetarëve reflektohet në:

1. Sa përfitojnë qytetarët nga përdorimi i fondeve publike në produkte dhe shërbime?
2. Si e përmirësojnë jetën e qytetarëve këto shpenzime publike?
3. Sa me efektivitet dhe me efizienz përdoren këto fonde?

Ky koncept më i gjerë i administrimit publik përfshin jo vetëm zbatimin e metodave të tilla, që përdoren zakonisht në fushën e biznesit privat, si analiza kosto/përfitime (Cost-Benefit Analysis) për investimet, por edhe përfshirjen e publikut në vendimmarrje nëpërmjet këshillimit publik, si dhe mobilizimin e përkrahjes publike dhe të grupeve të interesave. Në Simpoziumin në fjalë u konkludua se është koha që *“administrimi publik rifokusohet në veprimtari të veçanta në fushën e proceseve politike dhe vendimmarrëse, në menaxhimin e burimeve njerëzore e financiare, në përdorimin e teknikave rregullatore dhe të mekanizmave të tregut.”*

Sigurimi i akauntabilitetit mund të jepet në mënyrën më efektive nëpërmjet matjes së performancës së programeve shtetërore dhe të shërbimeve publike dhe vendosjes së auditimit mbi këto programe. Në fakt, për të implementuar

këtë koncept, qeveritë e vendeve më të përparuara kanë filluar të krijojnë dhe konsolidojnë të ashtuquajturat sisteme të matjes së performancës ose sisteme të akauntabilitetit të performancës.

Institucione të ndryshme me përvojë në këtë fushë e adresojnë këtë koncept në mënyra të ndryshme, në përputhje edhe me audiencën e tyre. Kështu, organizmat e Breton Woods-it, duke pasur përparësi si fushë veprimi vendet në zhvillim, përpiqen ta adresojnë problemin në mënyra më modeste. Sipas Bankës Botërore, Menaxhimi i Shpenzimeve Publike (PEM) është fusha më kritike e politikës publike, por edhe më pak e ekzaminuara nga nënshtetasit, për shkak të natyrës teknike të kësaj fushe. Përvoja sugjeron se zbatimi i proceseve pjesëmarrëse, i vetëm nuk është në gjendje të sigurojë suksesin dhe ky lloj angazhimi duhet mbështetur në veçanti prej:

1. rregullimeve institucionale, për të ndërmjetësuar veprimin civil publik;
2. përdorimit të strategjive të informacionit publik, për të përhapur informacionin.

Rregullimet institucionale më të efektshme mund të kategorizohen si më poshtë:

- 1.1 Sistem informimi publik dhe komunikimi.
  - 1.2 Trajnime për sektorët më të rëndësishëm të shoqërisë civile si NGO dhe media.
  - 1.3 Institucione kërkimore të cilat kryejnë studime për ecuritë buxhetore. Strategjitë e informacionit publik janë të dylllojshme:
  - 2.1 Përdorimi i internetit, portalet qeveritare.
  - 2.2 Komunikimi i drejtpërdrejtë publik i rregullt i institucioneve.
- Nismat për angazhim civil në PEM duhen drejtuar në të tri fazat e procesit të përpunimit të një plani të PEM-it:

1. Formulimi dhe analiza (ose për çfarë të buxhetojmë).
  2. Monitorimi i shpenzimeve publike (për çfarë dhe si duhet shpenzuar).
  3. Monitorimi i performancës (si është kryer puna dhe me çfarë cilësie).
- Rruga e propozuar nga OECD-ja është e një alternative tjetër, e cila fokusohet në ndryshime në rolin dhe strukturën e qeverisë, duke inkorporuar

edhe idenë se nënshtetësit duhen trajtuar më shumë si konsumatorë. Ndër masat e propozuar nga OECD-ja janë:

1. Decentralizimi i autoritetit.
2. Riekzaminim i përparësive për shpenzime publike.
3. Privatizim dhe korporatizim i veprimtarive publike.
4. Përdorimi i metodave të reja më kost-efektive për furnizimin e shërbimeve për publikun, si subkontraktimi, mekanizmat e tregut etj.
5. Vendosja e standardeve të cilësisë për shërbimet publike.
6. Benchmarking-u dhe matja e performancës.
7. Thjështësim i procesit rregullator.

Ndër sfidat kryesore të identifikuara nga OECD-ja është vështirësia e infrastrukturës aktuale dhe e burimeve njerëzore, për të përballuar hapjen ndaj teknologjive të informacionit, e cila mund ta vejë administratën shtetërore nën presion për shkak të volumit të komunikimit me publikun dhe të pamjaftueshmërisë së formimit të administratës në fushën e ICT-së.

Rasti Shqipëri: Menaxhimi i shpenzimeve publike te ne.

Menaxhimi i shpenzimeve publike në vendin tonë bëhet kryesisht nëpërmjet ligjit për Buxhetin e Shtetit dhe atij të prokurimeve publike. Të dy këto ligje kryesisht përcaktojnë procedurat në proceset e buxhetimit dhe të prokurimit. Ligji nr.7971, datë 26.7.1995 “Për Prokurimin Publik” (i amenduar disa herë) ka prapë vend për përmirësime dhe fuqizimin e mekanizmave institucionale të kontrollit. Sidoqoftë, ka përpjekje të vazhdueshme dhe akumulim përvoja në këtë fushë dhe mund të themi se po ecim drejt praktikave më racionale dhe transparente, sido që le ende për të dëshiruar zbatimin e teknologjive të reja si e prokurimit etj., të cilat do të mundësojnë një kontroll më të mirë të administrimit të fondeve të alokuara. Përsa i përket proceseve të buxhetimit, këtu ka ende shumë punë për të bërë, për të futur teknika të reja për planifikimin e fondeve dhe, më e rëndësishmja, për të krijuar kapacitete adekuate për planifikim të drejtë me metoda bashkëkohore të burimeve të kufizuara që kemi në dispozicion në planin afatshkurtër,



afatmesëm dhe afatgjatë. Ende mungojnë, për shembull, studime të detajuara për të përcaktuar përparësitë e ekonomisë sonë në kontekstin e konkurrencës rajonale. Kjo do të na ndihmonte për të alokuar fondet në funksion të rritjes së kompetivitetit të industrive tona me potencial më të madh për konkurrencë rajonale dhe në mënyrë të tërthortë do të ishim më eficientë në alokimin e burimeve dhe, pra edhe të përdorimit të shpenzimeve publike.

Vitet e fundit vërehen praktika qeverisëse më transparente, por edhe këto janë ende të painstitucionalizuara. Këto praktika më transparente po përdoren më shumë në projekte të realizuara me donatorë të huaj.

Dokumenti më autoritar që mbështet perspektivën e zhvillimit të vendit në kuadrin afatmesëm, duke caktuar përparësitë për alokimin e shpenzimeve publike, padyshim është Strategjia Kombëtare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social (SRERV), miratuar nga Qeveria në nëntor 2001. Në këtë dokument Qeveria pak a shumë i është përmbajtur vizionit relativisht modest të institucioneve të Breton Woods-it, duke theksuar në radhë të parë pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm në procesin e krijimit të strategjisë dhe të monitorimit të saj, sidomos prej shoqërisë civile, e cila nëpërmjet Grupit Kombëtar Këshillimor të Shoqërisë Civile (GKKSHC) ka marrë përsipër mes të tjerave, edhe rishikimin dhe oponencën e SRERV-së. Natyrisht, vëmendje i kushtohet edhe përdorimit të strategjive për përhapjen e informacionit në veçanti dhe, sado në një shkallë më të vogël, të rregullimeve institucionale në funksion të mbështetjes së pjesëmarrjes.

Kreu më i veçantë që do të duhej të adresonte këtë problem është IV.C: *Qeverisja dhe Menaxhimi i Sektorit Publik*. Në këtë kapitull trajtohet Programi Buxhetor Afatmesëm (PAB) si një aspekt i rëndësishëm dhe i veçantë (Dritare 4). Megjithëse bëhet një përshkrimi i plotë i qëllimeve dhe i elementeve kryesore të PAB-it, mekanizmat institucionale që do të garantojnë kontrollin e alokimit optimal të shpenzimeve publike ose nuk janë parashikuar, ose janë përfshirë në dokument. Në kreun V.B, i cili shqyrton monitorimin e SRERV-it dhe në këtë kuadër të shpenzimeve publike, vëmendja

është përqendruar në kontrollin e zbatimit dhe jo në optimalitetin e planifikimit. Në kreun IV, gjithashtu, një vëmendje e veçantë i kushtohet decentralizimit dhe ndër përparësitë kryesore theksohen efektet pozitive të tij në alokimin optimal të burimeve. Sidoqoftë, mënyrat sesi do të kontrollohet ky alokim, efienca dhe efektiviteti i shpenzimeve publike të kryera nga ana e organizmave të pushtetit vendor nuk trajtohen në këtë dokument.

Në tërësi, bie në sy që vëmendja është përqendruar disproporcionalisht te transparenca e shpenzimeve publike, kurse aspekti i efiençës dhe i efektivitetit të tyre është trajtuar në rastin më të mirë jo në nivelin e duhur dhe në vija të përgjithshme formalisht. Pikërisht çështja e efiençës dhe e efektivitetit (e cila ngre tërthorazi edhe nevojën e planifikimit koherent të shpenzimeve publike) është në rend të ditës nga vendet e OECD-së që po reformojnë shpenzimet publike. Megjithëse ne nuk jemi në nivelin e këtyre vendeve, por aspirojmë të jemi se paku treg emergjent, pra, të përfshihemi gradualisht në OECD, pavarësisht nga fakti që kemi GDP-në të krahasueshme me vendet më pak të zhvilluara, ne kemi potencialet që të fillojmë të zbatojmë me guxim disa formula më të përparuar që rekomandon OECD-ja. Në radhë të parë është e nevojshme të vendosim standarde cilësie për shërbimet publike, qoftë edhe në nivele më të ulta. Mbi bazën e këtyre standardeve do të mund të bëjmë, duke zbatuar benchmarking, matjen e performancës dhe, në përputhje me performancën, do të mund të alokonim fondet më me efiençë. P.sh., zbatimi i standardeve në arsim, si sistemet e akreditimit etj., do të stimulonte institucionet që arrijnë e tejkalojnë standardet dhe do të ndëshkonte nënperformuesit. Ndër efektet pozitive të kësaj formule që zbatohet në arsimin publik të shumë vendeve, do të ishte nxitja e konkurrencës dhe rritja e cilësisë për të njëjtën sasi fondesh të alokuara, pra rritje e efiençës.

Mekanizmat e tregut dhe subkontraktimi i shërbimeve publike pothuajse nuk përmenden në strategjinë e menaxhimit të shpenzimeve publike. Është koha që ne të përdorim aftësitë e mëdha sipërmarrëse të shqiptarëve, që është ndoshta aseti ynë më i madh.

## Zhvillimet e sigurimeve shoqërore dhe domosdoshmëria për ndryshime

*Naim Hasa*  
*Drejtor i Përgjithshëm i ISSH*

Sistemi i sigurimeve shoqërore, si një ndër institucionet e rëndësishme për zbatimin e politikave sociale, ka si mision kryesor mbështetjen me të ardhura të shtetasve në moshën e pleqërisë, në rastet e invaliditetit, të paaftësisë së përkohshme në punë për shkak sëmundjeje, si dhe në rastet e lindjeve, të vdekjes dhe të papunësisë.

Në themel të tij sistemi i reformuar i sigurimeve shoqërore ka parimin kontributiv, i cili presupozon që për kontribute të barabarta të garantojë përfitime të barabarta, si dhe parimin e solidaritetit social të brezit të ri me brezin e moshuar, të brezit ekonomikisht aktiv me grupmoshën joaktive të shoqërisë.

1. Një sistem që reformohet në shërbim të të sotmes dhe të ardhmes  
Gjatë nëntë vjetëve të ekzistencës së vet sistemi i reformuar i sigurimeve shoqërore ka përjetuar dy faza të rëndësishme.

Faza e parë ishte ajo e ristrukturimit dhe e përballimit të problemeve të shumta të emergjencës, që shoqëruan tranzicionin nga plani në treg. Ndërsa faza e dytë, që është në proces, ka si objektiv themelor përsosjen e mëtejshme dhe konsolidimin financiar të sistemit, me qëllim që t'u përshtatet zhvillimeve social-ekonomike të vendit dhe të aftësohet për të përballuar sfidat që shtron koha.

Në zbatim të objektivave të fazës së dytë, krahas menaxhimit dhe përballimit të detyrave koherente dhe afatshkurtëra, Instituti i Sigurimeve

Shoqërore, në bashkëpunim edhe me përfaqësuesit e partnerëve socialë, punëmarrës e punëdhënës, ka ndërmarrë dhe ka përfunduar disa studime e prognozime afatgjata.

Analiza e dinamikës së treguesve sintetikë tregon se skema e sigurimeve shoqërore e reformuar, në përgjithësi, e ka justifikuar veten dhe ka shënuar përmirësime të vogla, por domethënëse, drejt konsolidimit dhe forcimit të saj. Ndër treguesit më të rëndësishëm sintetikë që mbështesin këtë pohim, përmendim rezultatin financiar të skemës së sigurimeve shoqërore. Duhet vlerësuar si prirje pozitive dhe si arritje ulja e vazhdueshme e madhësisë së subvencioneve të Buxhetit të Shtetit, për të përballuar deficietin e skemës. Madhësia e subvencioneve ka ardhur në rënie. Nëse në vitin 1993 subvencionet përbënin 3.27 për qind të GDP-së, në vitin 2001 ato janë shmangur krejtësisht.

Megjithë arritjet dhe përmirësimet e shënuara në përsosjen dhe forcimin e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të sigurimeve shoqërore, duhet pohuar se ai përballlet ende me probleme dhe shqetësime. Ndërmjet tyre duhen veçuar: niveli ende i ulët, madje brenda kufijve të konsideruar si kritikë, i normës së varësisë që shpreh raportin kontribues/përfitues. Ky tregues aktualisht është 1 me 1,06.

Të njëjtën gjë dëshmojnë edhe treguesit e tjerë themelorë të skemës së sigurimeve. Kështu, shkalla e zëvendësimit, që shpreh raportin midis masës së pensionit mesatar dhe pagës mesatare, qëndron ende në nivel të ulët, vetëm 47 për qind. Vazhdon të jetë mjaft e ulët masa e përfitimeve nga pensionet dhe, megjithë punën e bërë deri tani, vazhdojnë të ekzistojnë dallime midis masës së pensioneve, të lidhura me legjislacione të ndryshme. Treguesi i shkallës së mbulimit, që shpreh raportin ndërmjet kontribuesve dhe numrit real të krahëve të aftë për punë, megjithë përmirësimet vazhdon të jetë i ulët, veçanërisht për sektorin privat të ekonomisë, fakt ky që dëshmon për ekzistencën e evazionit në pagesën e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore. Më në fund edhe ngarkesa kontributive prej 42.5 për qind, që duhet të

paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit në dobi të sigurimeve shoqërore, konsiderohet si mjaft e lartë dhe si faktor që nxit evazionin në skemë.

Vështirësitë dhe problemet e renditura nuk janë shqetësime vetëm të sistemit tonë të sigurimeve shoqërore. Me këto probleme e vështirësi financiare po përballen pothuajse të gjitha sistemet e sigurimeve shoqërore kudo në Europë. Natyrisht përmasat dhe intensiteti i vështirësive për sistemin tonë të sigurimeve shoqërore rezultojnë më të larta krahasuar me vendet e tjera.

Nga studimet e kryera kanë dalë në pah jo vetëm problemet dhe vështirësitë me të cilat përballlet aktualisht sistemi i sigurimeve shoqërore, por njëherazi janë formuluar edhe ndryshimet dhe përmirësimet që i duhen bërë këtij sistemi në parametrat kryesorë të tij. Ndryshimet kryesore parametrike që i duhen bërë sistemit të sigurimeve shoqërore janë:

- reforma për rritjen e moshës së daljes në pension pleqërie;
- ulja graduale e ngarkesës kontributive që paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit për sigurimet shoqërore;
- afrimi gradual me objektivi final njësimin e skemës së pensioneve të fshatit me ato të qytetit;
- rritja e madhësisë së pagës minimale dhe e diapazonit midis saj dhe pagës maksimale të tatueshme për efekt të llogaritjes së kontributeve për sigurime shoqërore;
- zhvillimi i skemave të sigurimit suplementar dhe krijimi i mundësive për funksionimin e skemave private të pensioneve.

Funksionimi normal dhe ruajtja e qëndrueshmërisë financiare të sistemit të sigurimeve shoqërore kërkon të mbahen në konsideratë dhe të harmonizohen të gjithë parametrat bazë të tij të përmendura më sipër. Kjo sepse çdo ndryshim i një parametri ndikon dhe reflektohet edhe në parametrat e tjerë, sipas disa ligjësive të brendshme të vetë sistemit të pensioneve të tipit “pay-as-you-go”. Në këtë vështrim, për shembull, nuk mund të ulet vetëm norma e kontributeve në mënyrë të shkëputur nga parametrat e tjerë

të sistemit. Kjo sepse do të ndikonte në pakësimin e të ardhurave të skemës së sigurimeve shoqërore dhe, po nuk u shoqërua me reformën e ndonjë parametri tjetër që ndikon në uljen e shpenzimeve, do të shpinte në rritjen e deficitit dhe në paqëndrueshmërinë financiare të skemës. Në këtë kontekst është parashikuar që sistemi të reformohet në të gjithë parametrat e tij, por mënyra dhe koha e reformimit të çdo parametri është e sfazuar në kohë.

Gjatë vitit 2002, procesi i reformimit ka përfshirë tri parametra të tij dhe konkretisht:

Së pari, rritjen e diapazonit midis pagës minimale dhe maksimale të tatueshme për efekt të llogaritjes së kontributeve për sigurime shoqërore, reformë e cila ka filluar të zbatohet qysh nga fillimi i këtij viti.

Së dyti, uljen graduale të ngarkesës kontributive që paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit për sigurimet shoqërore, reformë e cila është parashikuar të fillojë në gjashtëmuorin e dytë të vitit 2002.

Së treti, reformën për rritjen e moshës së daljes në pension pleqërie.

2. Ulja graduale e ngarkesës kontributive që paguajnë punëdhënësit dhe punëmarrësit për sigurimet shoqërore.

Sipas dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore”, punëmarrësit dhe punëdhënësit e tyre aktualisht paguajnë kontribute për sigurimet shoqërore në masën 42.5 për qind të pagës. Nga shuma e përgjithshme e kontributeve prej 42.5 për qind, pjesa prej 31.7. për qind kalon për financimin e shpenzimeve në degën e pensioneve.

Norma e kontributeve për pensione vlerësohet nga specialistët dhe opinioni publik si shumë e lartë. Prandaj është parashikuar që gjatë këtij viti të bëhet një ulje e masës së kontributit prej 4 për qind dhe efektet financiare parashikohen të fillojnë nga 1 korriku i vitit 2002.

Kjo reformë, që ndërkohë do të përmirësojë treguesit në tregun e punës, do të ndikojë negativisht në bilancin financiar të sigurimeve shoqërore, sepse në periudhat e ardhshme praktikisht do të paguhet e akumulohet më pak në favor të sigurimeve.

Disa nga arsyet kryesore që diktojnë ndërmarrjen e kësaj reforme janë:

Së pari, konstatimi se ngarkesa ekzistuese e kontributeve është mjaft e lartë, madje më e lartë nga ajo e vendeve të tjera përfshirë këtu edhe vendet e Europës Qendrore e Lindore.

Së dyti, elemente të veçanta të kontributeve për sigurimet shoqërore, si ato për sëmundje, për shpërblimet për lindje e barrë lindje, si dhe për papunësi, gjatë viteve të fundit kanë rezultuar përgjithësisht me kursime në raport me shpenzimet e kryera për këto qëllime.

Së treti, norma relativisht e lartë e evazionit që vërtetohet vitet e fundit në vjeljen e kontributeve të sigurimeve shoqërore sidomos nga sektori privat i ekonomisë.

Ka arsye të besohet se reduktimi i normës së kontributeve do të ketë efekt ekonomik të dyanshëm. Në çastin fillestar do të ndikojë në uljen e të ardhurave financiare në skemën e sigurimeve shoqërore. Por mendohet se kjo ulje do të jetë e përkohshme dhe do të kompensohet me kalimin e kohës përmes rritjes së interesit të të punësuarve dhe punëdhënësve, për t'u përfshirë më gjerë në skemën e sigurimeve shoqërore.

Nga zbatimi i reformës për uljen e ngarkesës kontributive efektet financiare në buxhetin e ISSH-së do të jenë negative, sepse pakësohen të ardhurat nga kontributet. Për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2002 ky efekt negativ financiar llogaritet të jetë 990 milionë lekë, ndërsa ai vjetor për vitin 2003 do të jetë rreth 2 miliardë lekë. Kuptohet se kjo kosto që duhet të përballohet nga skema e sigurimeve shoqërore është një përfitim financiar i drejtpërdrejtë për punëdhënësit dhe punëmarrësit që kontribuojnë në skemë.

Përballimi i kësaj kostoje nga ISSH-ja do të kërkojë intensifikimin e mëtejshëm të përpjekjeve të tij për rritjen e numrit të kontribuesve, si rezultat i reduktimit të evazionit, përsosjen e menaxhimit të fondeve, sidomos të atij rezervë, por njëkohësisht edhe bashkëshoqërimin me reformën tjetër që propozohet për rritjen e moshës së daljes në pension. Vetëm gjatë këtij viti

është programuar që numri i kontribuesve në skemën e sigurimeve shoqërore të rritet edhe me rreth 120 mijë persona të tjerë.

### 3. Reforma për rritjen graduale të moshës së daljes në pension.

Mosha e daljes në pension në ligjin e miratuar parashikohet të rritet me 6 muaj çdo vit deri në arritjen e moshës 65 vjeç për burrin dhe 60 vjeç për gruan. Pra, kjo reformë do të kryhet në mënyrë graduale gjatë një harku kohor prej 10 vjetësh, duke filluar nga viti 2002 e duke përfunduar në vitin 2012.

Gjithashtu, duhet specifikuar se kjo reformë nuk rrit moshat e daljes në pension të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira. Ata do të vazhdojnë të dalin në pension sipas ligjit ekzistues deri në vitin 2014.

Disa nga arsyt kryesore që diktojnë ndërmarrjen e kësaj reforme janë:

*Së pari*, nga zhvillimet dhe prognoza e situatës demografike të vendit. Nën ndikimin e ndryshimeve në shtesën natyrore të popullsisë, të rritjes së jetëgjatësisë mesatare të popullsisë dhe sidomos të emigracionit në përmasa shumë të mëdha të moshave të reja, në Shqipëri ka filluar dhe do të vazhdojë prirja e vjetërimit të popullsisë. Kështu, në vitin 2020 pjesa e popullsisë së grupmoshës së tretë parashikohet të përbëjë mbi 15 për qind të popullsisë së përgjithshme, nga 9,4 përqind që ishte në vitin 2000. Kjo reflektohet drejtpërsëdrejti në rritjen e numrit të përfituesve, si dhe të kohëzgjatjes mesatare të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Në këto rrethana, popullsia ekonomikisht aktive nuk mund të sigurojë qëndrueshmërinë financiare të skemës dhe shkallën e kërkuar të zëvendësimit të pensionit.

*Së dyti*, nga përkeqësimi i raportit kontribues-përfitues, i njohur gjerësisht si raport mbështetës ose i varësisë, i cili nga tre deri katër kontribues për një përfitues që ishte para 1990, zbriti në kufirin 0,8 kontribues për një përfitues në vitin 1997 dhe aktualisht është 0,94.

*Së treti*, domosdoshmëria e zbatimit të kësaj reforme parametrike buron edhe nga kërkesa për ta përafuar legjislacionin shqiptar në këtë fushë



me atë të vendeve të tjera të rajonit, si dhe për të ndikuar në minimizimin e efekteve negative të zhvillimeve demografike.

Krahasuar me vendet e tjera, në Shqipëri moshë e daljes në pension është relativisht më e ulët. Kështu, ndërsa në Shqipëri moshë për pension të plotë pleqërie është 55 për femrat dhe 65 për meshkujt, në Poloni është 60 për femra dhe 65 për meshkuj, në Bullgari 60 për femrat dhe 63 për meshkujt, në Kroaci 60 për femrat dhe 65 për meshkujt etj.

*Së katërti*, domosdoshmëria e forcimit të gjendjes financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, si dhe për të kompensuar efektet negative financiare të reformës tjetër të uljes së masës së kontributeve.

Rritja graduale e moshës së daljes në pension do të reduktojë shpenzimet për pagesën e pensioneve në mënyrë graduale, duke sjellë si pasojë përmirësimin e bilancit financiar të skemës së pensioneve. Duke parashikuar fillimin e kësaj reforme në muajin korrik 2002, nga ky muaj, kostoja e pensioneve të qytetit reduktohet me 38.057 mijë lekë në muaj dhe kostoja për pensionet e fshatit me 4 296 mijë lekë. Në total shuma mujore është 42 353 mijë lekë. Për vitin 2002, efektet financiare nga zbatimi i kësaj reforme parashikohen 252 milionë lekë.

Zbatimi i reformës së rritjes së moshës së daljes në pension ka efekte pozitive në pakësimin e shpenzimeve dhe në fuqizimin e qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore. Por ndërkaq, ajo ka disa efekte negative anësore sociale, sidomos në ato që lidhen me marrëdhëniet me tregun e punës.

Për të zbutur efektet negative sociale të kësaj reforme, janë parashikuar disa masa kryesore:

*Së pari*, rritja e moshave të pensionit do të bëhet gradualisht për një periudhë dhjetëvjeçare dhe për më tepër punonjësit e kategorive të vështira nuk do të preken nga kjo reformë deri në vitin 2014.

*Së dyti*, për të trajtuar në mënyrë të veçantë dhe afatgjatë punonjësit e disa sektorëve të vështirë, që nuk mund të përballohen me moshat e pensionit

të parashikuara në këtë projektligj, do të nxiten, mbështeten dhe zhvillohen format e sigurimit suplementar, institute private të pensioneve, si dhe fondet profesionale të pensioneve. Parimi i funksionimit të këtyre sistemeve është: kush dëshiron pension para mbushjes së moshës ose përfitime më të mëdha, kontakton me këto institucione.

*Së treti*, në projektligj është vendosur një dispozitë, e cila parashikon që, pasi personi të ketë mbushur një moshë të caktuar dhe kur largohet nga tregu i punës, t'i lindë e drejta të marrë një pension të reduktuar.

Vendosja e skemës së pensioneve të reduktuara të pleqërisë, e kombinuar me skemën e rritjes graduale të moshës së daljes në pension të plotë, krijon mundësinë që personat, që nuk mund të integrohen në tregun e punës, të përfitojnë një pension.

Neni 5 i projektligjit parashikon një nen të ri, i cili u jep mundësi atyre që kanë arritur moshat 62 (burrat) dhe 57 (gratë) për të marrë pension të plotë pleqërie, por të reduktuar.

Masa e reduktimit është e lidhur me vitet para mbushjes së moshës që kërkohet për pension.

Koefiçienti i reduktimit varet nga koha e gëzimit të pensionit dhe pensioni mesatar. Sipas disa treguesve të përafërt, koefiçienti i reduktimit për një vit mendohet të jetë 6.5-7 për qind. Pra, pensioni i reduktuar, nëse do të kërkohet të merret para një viti, do të jetë 93.5-97 për qind e pensionit të plotë ose për tre vjet do të jetë 19.5-21 për qind, që do të thotë të marrësh 80.5-79 për qind të pensionit të plotë.

Sot në të gjitha vendet e botës zbatohet ky lloj pensioni. Koefiçienti i reduktimit pritet të llogaritet deri më 31.12.2002 pas përfundimit të përpunimit të rezultateve të regjistrimit të popullsisë nga INSTAT-ti, ku do të dalë edhe jetëgjatësia mesatare e popullsisë.

Sigurisht kjo reformë do të shoqërohet edhe me përmirësimin e dispozitave të tjera që kanë lidhje me masat e përfitimit nga pensioni në raport me kontributet e paguara, ato për nxitjen e punësimit, ku të favorizohen punëdhënësit që mbajnë në punë punonjës mbi moshat 55 e 60 vjeç etj.

4. Disa nga drejtimet themelore të zhvillimit të sistemit të sigurimeve shoqërore në një periudhë afatmesme dhe afatgjatë.

Zhvillimi i sistemit të sigurimeve shoqërore është bërë në bazë të një programi të përcaktuar e të studiuar me kujdes dhe me mbështetjen dhe asistencën e organizmave ndërkombëtarë si Banka Botërore etj. Nëse do të bënim një sintezë të zhvillimit të këtij sistemi në këto afro 10 vjet të ekzistencës së tij, do të dallonim se ai ka përjetuar tri etapa të rëndësishme:

Etapa e parë 1992-1995 është ajo e strukturimit dhe përballimit të problemeve të emergjencës. Objektivat strategjike të kësaj periudhe u realizuan dhe mundësuan krijimin e një sistemi të ri të sigurimeve shoqërore si në përmbajtje dhe në format e organizimit të tij.

Periudha e dytë 1996-2001 është periudha e stabilizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore. Sintezë e këtij procesi janë rezultatet financiare. Sot sigurimet shoqërore janë institucione të fuqishme financiare. Administrojnë një buxhet që përfaqëson 20.5 % të Buxhetit të Shtetit. ISSH-ja çdo muaj kontakton me gjysmën e popullsisë, duke siguruar mbi 850 mijë vetë dhe paguan përfitimet për 730 mijë përfitues, nga këta 526 mijë pensionistë ose 16 për qind e popullsisë.

Por situata ekonomike e financiare e vendit dhe veçanërisht stabiliteti kanë refleksionet e veta dhe në sistemin e sigurimeve shoqërore. Si rrjedhojë e emigracionit, papunësisë së lartë, punës joformale është ulur ndjeshëm numri i kontribuesve në raport me popullsinë aktive.

Këto dhe një sërë problemesh e faktorë të tjerë që veprojnë brenda dhe jashtë sistemit, kanë bërë evidente kalimin në një etapë tjetër, që do të konsiderohej etapa e ndryshimeve, për t'iu përshtatur zhvillimeve social-ekonomike dhe për të përballuar sfidat që shtron koha.

Që nga viti 1997 kanë filluar përpjekjet për të formuluar një strategji afatmesme të zhvillimit të sistemit e për të kaluar gradualisht në përcaktimin e një strategjie afatgjatë, e cila është duke u përfunduar.

Ndërmarrja e këtij studimi ishte e domosdoshme, për të reflektuar

mbi ndryshimet ekonomike, sociale e demografike që kanë ndodhur në vend, sidomos këto vitet e fundit.

Strategjia e ripunuar u aktualizua me rezultatet e nxjerra nga përpunimi i të dhënave të regjistrimit të fundit të përgjithshëm të popullsisë. Ai do të fokusohet në hartimin e një kronograme konkrete që do të përcaktojë ato reforma parametrike që i duhen bërë sistemit të sigurimeve shoqërore në vitet e ardhshme, me qëllim që ai të bëhet më bashkëkohor dhe më i qëndrueshëm financiarisht.

Studimi synon t'u japë përgjigje, si dhe rrugëzgjdhje njëherazi disa pyetjeve dhe shqetësimeve që vërehen në sistemin e sigurimeve shoqërore. Ndërmjet këtyre pyetjeve si më të rëndësishme po përmendim:

- Cilat janë disa nga problemet më shqetësuese në sistemin ekzistues të sigurimeve shoqërore?

- Si do të shkojë shkalla e qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore në perspektivën afatgjatë në kushtet e ruajtjes së pandryshuar të parametrave kryesorë të sigurimeve shoqërore?

- A është i përshtatshëm sistemi ekzistues i sigurimeve shoqërore në formën e tij aktuale?

- Cilat do të ishin disa nga ndryshimet që u duhen bërë parametrave kryesorë të sistemit të sigurimeve shoqërore, kur duhen bërë ato nga pikëpamja kohore, modalitetet që kërkohen dhe cilat do të jenë ndikimet e tyre në rezultatin financiar të skemës?

- Cilat do të ishin disa nga rrugët kryesore për përsosjen dhe fuqizimin e mëtejshëm financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore në rrjedhën e kohës etj.

Në pjesën e parë, mbi bazën e analizës së ecurisë së treguesve bazë të skemës së sigurimeve shoqërore qysh nga viti 1993, kur u miratua ligji i ri i sigurimeve shoqërore e deri në vitin 2001, evidentohen dhe analizohen arritjet dhe problemet shqetësuese që vihen re në skemë, si dhe faktorët që i kanë sjellë ato.

Objekt shqyrtimi të hollësishëm në këtë pjesë të parë bëhet një rreth i gjerë treguesish të skemës së sigurimeve. Ndërmjet tyre veçojmë dinamikën e numrit të kontribuesve dhe përfituesve në skemë, dinamikën e të ardhurave nga kontributet dhe e shpenzimeve për përfitime të ndara sipas degëve të sigurimit dhe në total, treguesin e shpenzimeve në përqindje ndaj GDP-së, defiçitin e Buxhetit të ISSH-së dhe subvencionet e Buxhetit të Shtetit për këtë skemë sipas viteve.

Gjithashtu, objekt analize e studimi janë bërë dhe treguesit sintetikë të skemës, si: masa e pensionit nominal dhe atij real, shkalla e zëvendësimit të pensionit, shkalla e mbulimit, koefiçienti i varësisë etj.

Në pjesën e dytë bëhet prognozimi afatgjatë dhe analiza e ecurisë së të ardhurave të shpenzimeve, si dhe e rezultatit financiar të skemës ekzistuese të sigurimeve shoqërore, duke i ruajtur të pandryshuar parametrat kryesorë të tij. Për kryerjen e prognozës së rezultatit financiar të skemës së pensioneve, fillimisht, duke u nisur nga rezultatet e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë të vitit 2001, u prognozua numri i popullsisë sipas tri grupmoshave dhe jo vetëm në total për gjithë Republikën, por edhe me ndarje sipas vendbanimit: veçmas për popullsinë urbane dhe veçmas për atë rurale.

Më tej objekt studimi dhe prognozimi është bërë dhe dinamika e rritjes ekonomike dhe ajo e punësimit, prej nga dalin të dhënat e nevojshme mbi prognozimin e numrit të kontribuesve, të përfituesve, mbi të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatit financiar të skemës së sigurimeve shoqërore në perspektivën afatgjatë. Më në fund në këtë pjesë do të analizohet ecuria e dinamikës së rezultatit financiar të skemës në periudhën afatgjatë dhe do të nxirren përfundimet dhe rekomandimet përkatëse për domosdoshmërinë e përsosjes së skemës ose të parametrave të veçantë të saj.

Në pjesën e tretë, që përbën edhe pjesën më të rëndësishme të këtij studimi, do të trajtohen ndryshimet e parametrave kryesorë që i duhen kryer skemës së sigurimeve në periudhën afatmesme deri në vitin 2005 dhe më tej në periudhën afatgjatë, për ta bërë atë sa më bashkëkohore dhe sa më të

fuqishme nga pikëpamja financiare. Analiza e këtyre ndryshimeve parametrike do të bëhet në tri drejtime kryesore:

Drejtimi i parë do të rrokë ato ndryshime që ndikojnë drejtpërsëdrejti dhe vetëm në fuqizimin e qëndrueshmërisë financiare të skemës, siç janë: rritja e diapazonit ndërmjet pagës minimale dhe asaj maksimale të tatueshme, për efekt të grumbullimit të përfitimeve në dobi të sigurimeve; përafrimi i skemës së pensioneve rurale me ato urbane dhe rritja e madhësisë së kontributeve të të vetëpunësuarve në zonën rurale, rritja e moshës së daljes në pension, si dhe masat për rritjen e numrit të kontribuesve në skemën e sigurimit të detyruar, por me kontribute vullnetare.

Drejtimi i dytë do t'i kushtohet ndryshimeve parametrike që fillimisht e rritin barrën financiare dhe ndikojnë negativisht mbi qëndrueshmërinë financiare të skemës së sigurimeve e që janë: ulja e ngarkesës kontributive për të punësuarit dhe punëdhënësit, rritja e shkallës së zëvendësimit të pensionit, rregullimi i diferencave të mëdha në masën e pensioneve të lidhura sipas ligjeve të ndryshme, si dhe përsosja e rregullave të indeksimit të pensioneve.

Pjesa e tretë do t'i kushtohet përsosjeve që u duhen bërë skemave të tjera të sigurimeve që menaxhohen nga ISSH-ja dhe konkretisht skemës së sigurimit vullnetar dhe skemës së sigurimit suplementar të punonjësve të administratës së lartë shtetërore.

Ndryshimet e mësipërme do të shqyrtohen në mënyrë komplekse në të tëra aspektet: në atë ekonomik me llogaritje konkrete të efekteve financiare në Buxhetin e ISSH-së; në atë legjislativ, me ndryshimet që kërkohen në bazën ligjore; në atë kohor, kur do të ishte periudha më e përshtatshme e kryerjes së tyre dhe mënyra e realizimit si një ndryshim i menjëhershëm ose si një proces gradual me etapa; në atë social, si ndikojnë në atraktivitetin e skemës për publikun dhe në masën e përfitimeve për pensionistët etj.

Të gjitha këto do të shoqërohen dhe me një kronogramë të reformave konkrete parametrike që do të zbatohen, të cilat, siç theksuam dhe më lart, kanë filluar me zbatimin e tri reformave të rëndësishme që gjatë këtij viti.

## **Të ardhurat tatimore dhe transparenca ndaj publikut për administrimin dhe përdorimin e tyre**

*Dr. Sefedin Guri*

Ndryshe nga sistemi i mëparshëm, ku të ardhurat e Buxhetit të Shtetit siguroheshin në mënyrë të tërthortë nëpërmjet së ashtuquajturës e ardhur neto e centralizuar e shtetit, ku shtetasi shqiptar nuk e dinte se sa ishte kontributi i tij në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit, në sistemin e ri që po ndërtojmë, të ardhurat kryesore të Buxhetit të Shtetit sigurohen nga tatimet dhe taksat, të cilat sipas nenit 155 të Kushtetutës vendosen vetëm me ligj.

Duke qenë se transparenca në veprimtarinë qeverisëse është thelbësore dhe me rëndësi jetike për zbatimin e parimeve themelore në një shtet demokratik, ka disa çaste të rëndësishme, ku kërkohet transparenca e Qeverisë ndaj publikut për veprimtarinë e saj, e cila ka të bëjë me politikën ekonomike për sigurimin e të ardhurave për Buxhetin e Shtetit dhe administrimin e përdorimin e tyre në interes të zhvillimit ekonomik e social të vendit.

Momenti i parë është informimi i publikut për veprimtarinë e Qeverisë në tërësi dhe në veçanti për politikën fiskale, sepse ajo ka të bëjë drejtpërsëdrejti me qytetarët.

E drejta e informimit të shtetasve për të gjithë veprimtarinë ekonomike e sociale të Qeverisë është e sanksionuar në Kreun II: “Liritë dhe të drejtat vetjake” të Kushtetutës, prandaj çdo shtetas tatimpagues ka të drejtë të informohet për llojin e taksave dhe tatimeve që duhet të paguajnë në bazë të ligjeve që vendos Kuvendi, si dhe për sasinë e të ardhurave që do të sigurohen nga tatimet e taksat dhe destinacionin e përdorimit të tyre.

Publiku duhet të informohet dhe të ftohet të japë mendime për nivelin e taksave dhe tatimeve që Qeveria vendos t'ia propozojë Kuvendit për miratim. Tërheqja e mendimit të publikut për politikën fiskale mund të organizohet në format nga më të ndryshmet, duke ftuar shoqatat e konsumatorëve dhe të biznesit ose organizatat joqeveritare të shprehin mendimet e tyre në mjetet e informimit publik ose në këshillime që mund të organizohen për këtë qëllim.

Për të siguruar burimet financiare të Buxhetit të Shtetit, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kompetencat që i ka dhënë Kushtetuta, ka miratuar paketën e ligjeve fiskale të përgatitur nga Qeveria, ku përfshihen: tarifat doganore, akcisat, tatimi mbi vlerën e shtuar, tatimi mbi fitimin, tatimi mbi biznesin e vogël, tatimi mbi të ardhurat, si dhe 22 lloje taksash kombëtare dhe 13 lloje taksash vendore. Të ardhurat nga taksat vendore lihen në dispozicion të bashkive dhe komunave për t'i përdorur në interes të bashkësisë.

Tashmë, taksapaguesit, në këto 11 vjet tranzicion, kanë filluar të ndërgjegjësohen për pagimin e tatimeve e taksave në bazë të ligjeve të sistemit fiskal. Megjithatë, prirjet për t'iu shmangur pagimit të tatimeve e taksave te një pjesë e konsiderueshme e biznesit janë ende të fuqishme.

Momenti i dytë është publikimi i informacionit për sasinë e të ardhurave tatimore dhe jotatimore që grumbullohen në Buxhetin e Shtetit dhe për mënyrën e administrimit dhe përdorimit të tyre.

Taksapaguesit e ndershëm kanë të drejtën morale të kërkojnë nga organet shtetërore që të mbledhin taksat dhe tatimet nga të gjithë personat fizikë a juridikë që i nënshtrohen pagimit të detyrimeve fiskale të vendosura me ligj nga shteti. Ata kanë të drejtë të kërkojnë llogari, me mjete demokratike, ndaj administratës shtetërore, kur shohin se abuzuesit dhe shkelësit e ligjeve të sistemit fiskal nuk vihen para përgjegjësisë ligjore dhe aq më tepër këta shkelës të ligjit bëjnë presion dhe kërkojnë shkarkimin e drejtuesve të organeve tatimore, të cilët kërkojnë zbatimin e ligjeve fiskale ndaj të gjithë tatimpaguesve.



Reagimi i taksapaguesve të ndershëm ndaj kontrabandës dhe shkelësit të ligjeve të sistemit fiskal është i ligjshëm, sepse kontrabanda dhe korrupsioni përbën një rrezik të madh për shtetin ligjor, demokracinë dhe të drejtat e njeriut, pastërtinë dhe drejtësinë sociale, sepse kontrabanda dhe korrupsioni pengojnë zhvillimin ekonomik dhe rrezikojnë funksionimin e drejtë dhe të duhur të ekonomisë së tregut, duke sjellë pasoja të dëmshme financiare ndaj individëve, kompanive vendase dhe të huaja dhe largon investitorët e huaj.

Në vendet në tranzicion, siç është edhe Shqipëria, vihet re një prirje e theksuar e taksapaguesve për t'iu shmangur tatimeve dhe taksave dhe, për të arritur këtë qëllim, përdorin rrugë nga më të ndryshmet, duke fshehur të ardhurat e realizuara nëpërmjet përdorimit të bilanceve fiktive, duke kompromentuar nëpunësit e administratës tatimore dhe doganore dhe, për çështjet që shkojnë në gjykata, përpiqen dhe në disa raste ia arrijnë të kompromentojnë edhe gjyqtarët.

Është fakt i pranuar nga i gjithë opinioni publik se për shkak të paaftësisë dhe të korrupsionit të administratës shtetërore, evazioni fiskal vazhdon të jetë i lartë. Pothuajse gjysma e sasisë së mallrave, për të cilat përveç taksës doganore dhe TVSH-së paguhet edhe akcizë, siç janë cigaret, kafeja, pijet alkolike, karburantet etj., hyjnë kontrabandë dhe nuk i nënështrohen detyrimeve doganore e tatimore dhe për këtë shkak shteti humbet me dhjetra dhe deri qindra milion dollarë.

Evazioni fiskal në sektorin e ndërtimit është me përmasa të jashtëzakonshme. Firma të fuqishme ndërtimi, të cilat arrijnë të ndërtojnë pallate shumëkatëshe, paguajnë në shtet detyrime sa një biznes i vogël ose sa një nëpunës i nivelit të mesëm të shërbimit civil.

Për 115 firma ndërtimi në Tiranë, të kontrolluara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, evazioni fiskal për vitin 1999 dhe vitin 2000 ishte 1476 milionë lekë vetëm për TVSH-në dhe për kontributin për sigurimet shoqërore. Ndërsa evazioni fiskal për tatimin mbi fitimin është i pamatshëm për shkak të paraqitjes së bilanceve fiktive, ndërkohë çmimi i shitjes së sipërfaqes së banimit është dy deri tri herë më i lartë se kostoja e ndërtimit.

Shmangia e një pjesë të konsiderueshme të bizneseve nga detyrimet fiskale, jo vetëm që është me pasoja për realizimin e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, por cënon barazinë para ligjit të të gjithë personave fizikë dhe juridikë, cënon dhe deformon konkurrencën e lirë dhe të ndershme, që është një ndër parimet themelore të ekonomisë së tregut.

Momenti i tretë është informimi i publikut gjatë procesit të hartimit dhe zbatimit të Buxhetit të Shtetit. Procesi i hartimit dhe miratimit të Buxhetit të Shtetit është jashtëzakonisht i rëndësishëm për sigurimin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë së Qeverisë. Prandaj paraqitja e detajuar e shpenzimeve shtetërore duhet t'i japë mundësi Kuvendit dhe publikut në përgjithësi për të ndjekur mënyrën e grumbullimit të të ardhurave dhe të shpërndarjes së fondeve. Kuvendi dhe publiku të njihen me përparësitë e Qeverisë dhe mënyrën se si dhe sa përdoren burimet shtetërore për të mirën e të gjithë vendit.

Qeveria ka për detyrë të bëjë publike të ardhurat që mund të sigurojë për Buxhetin e Shtetit sipas të gjitha llojeve të burimeve, ndërsa Kuvendi dhe, në veçanti, partitë e opozitës kanë të drejtën legjitime të bëjnë oponencën e veprimtarisë së Qeverisë dhe të kundërshtojnë në rrugë ligjore veprimet e Qeverisë, kur ato bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet.

Ka disa vite që Shqipëria po vuan pasojat e krizës energjetike dhe, për të përballuar efektet e kësaj krize, Buxheti i Shtetit ka disa vite që po shpenzon me miliarda lekë për përballimin e diferencës së çmimit të shitjes së konsumatorëve me çmimin e blerjes së energjisë nga jashtë. Për vitin 2002 sektori i energjetikës do të ketë një mbështetje buxhetore prej 7.5 miliardë lekësh.

Subveccionimi i çmimit të importit të energjisë elektrike ka dy anë të medaljes. Njëra anë është lehtësimi i konsumatorëve familjarë për konsumin e energjisë elektrike deri në 300 kw/h në muaj. Ana tjetër e padukshme e medaljes së subveccionit është paaftësia e administratës së KESH-it për të mbledhur paratë e energjisë së shitur.

Kriza energjetike nuk është kryesisht për shkak të motit të thatë. Kjo krizë para së gjithash është rrjedhojë e keqadministrimit të energjisë, e cila është trajtuar si mall pa zot. Keqadministrimi i energjisë elektrike u bë pengesë për disa vite për moslëvrimin e kredive të akorduara nga institucionet financiare ndërkombëtare për sektorin energjetik. Këto institucione vunë si kusht për lëvrimin e kredive uljen e humbjeve teknike dhe joteknike të energjisë dhe arkëtimin e detyrimeve të prapambetura, të cilat arrijnë në mbi 100 milionë USD.

Strategjitë e zhvillimit të degëve të rëndësishme të ekonomisë, siç është energjetika, e cila po i kushton Buxhetit të Shtetit me miliarda lekë, si dhe probleme të tjera madhore që kanë të bëjnë me përdorimin me efektivitet të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit, mund të bëhen objekt debatesh në Kuvend, nga ku mund të dalin edhe rrugëzgjidhje efektive.

Momenti i katërt është kontrolli i procesit të zbatimit të Buxhetit të Shtetit.

Duke qenë se financat publike përbëjnë themelet e ekonomisë së shtetit, nga ku përballohen të gjitha shpenzimet për mbajtjen e administratës shtetërore, për arsimin, kulturën dhe shëndetësinë, si dhe investimet për infrastrukturën, jo pa qëllim, mbi bazën e neneve kushtetuese është ngritur edhe institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, si një institucion i pavarur nga Këshilli i Ministrave, për të ushtruar kontroll për zbatimin e ligjeve për përdorimin e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Nga debatet e zhvilluara për zbatimin e Buxhetit të Shtetit janë evidencuar disa probleme:

Së pari, parashikimi i të ardhurave të Buxhetit të Shtetit bëhet me metoda empirike, sepse nuk ka një institucion të specializuar që të punojë me metodika shkencore për përcaktimin e të ardhurave të Buxhetit të Shtetit. Mungesa e metodikave shkencore për përcaktimin e të ardhurave lë shteg për evazion fiskal që në çastin e programimit të tyre. Kështu për shëmbull, ndonëse në Shqipëri, sipas llogaritjeve të specialistëve, konsumohen 5000-

6000 ton cigare në vit, programohen për t'u zhdoganuar 2000-3000 ton në vit. Kjo do të thotë që të ligjërosh hyrjen kontrabandë të gjysmës së sasisë të cigareve që konsumohen gjatë një viti në Shqipëri. Me të njëjtën logjikë mund të vazhdojmë edhe për mallra të tjera, si kafe, pije alkoolike, karburante, vajra lubrifikantë etj., për të cilat rezulton se konsumi është më i madh se sasia e mallrave që hyn ligjërisht në pikat doganore të vendit.

Së dyti, në programimin e të ardhurave të Buxhetit nuk, parashikohen detyrimet e prapambetura të subjekteve të ndryshme private dhe publike të cilat janë shtuar nga viti në vit dhe kanë arritur në më shumë se 19 miliardë lekë.

Së treti, ka shkelje të Kodit Doganor për përcaktimin e vlerës doganore, për regjimin e magazinave doganore, për licencimin e kontrollin e dyqaneve të çliruara nga taksat doganore dhe për tranzitimin e mallrave të importit.

Së katërti, janë të pranishme rastet e abuzimeve me fondet buxhetore, të cilat fillojnë me shkeljen e dispozitave ligjore për prokurimin e fondeve publike dhe deri lidhje kontratash me qëllim përfitimi vetjak.

Së pesti, ende kuadri ligjor për administrimin e vlerave materiale dhe monetare është i mangët, prandaj ka nevojë që të plotësohet dhe të forcohen masat shtërnguese ndaj personave që abuzojnë me pronën publike.

Së gjashti, ekonomia informale vazhdon të jetë një problem shqetësues dhe një gropë e zezë nga ku humbasin të ardhurat që duhet të derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Nga sa u tha më lart, arrihet në konkluzionin se potenciali ekonomik i shtetit shqiptar është për më shumë të ardhura në Buxhetin e Shtetit nga sa realizohen realisht dhe për më shumë shpenzime në fushat që mbulohen nga Buxheti i Shtetit. Por, realizimi i këtyre të ardhurave kushtëzohet nga fuqizimi dhe mirëfunksionimi i institucioneve.

## E Drejta Kushtetuese për informim

*Andrea Lako*

*Jurist*

*Instituti i Menaxhimit Lindje-Perëndim*

E drejta e informimit mbi dokumentet zyrtare është pjesë e së drejtës themelore të njeriut për informim mbi veprimtarinë e organeve shtetërore, në një shoqëri demokratike dhe shtet juridik.

Kjo e drejtë ka gjetur mbrojtje kushtetuese dhe ligjore në shumë vende të botës demokratike. Modalitetet e mbrojtjes, garantimit dhe rregullimit të saj kanë si nivel më të lartë Kushtetutën, ndërsa në nivel ligjesh ndeshen në tri lloje rregullimesh kryesore:

a) Vende që e kanë të sanksionuar atë me ligje të veçanta (SHBA, Kanada etj.), si dhe disa vende të Europës Lindore;

b) vende që e kanë të inkuadruar në ligje të ndryshme, si për shtypin, për organet e zgjedhura, për procedurat administrative etj.;

c) vende që formulojnë në një ligj të drejtën e informimit dhe atë të mbrojtjes së të dhënave vetjake.

Po kështu, zhvillimi i kësaj të drejte është konsideruar si një nga faktorët dhe instrumentet më të rëndësishme të transparencës qeverisëse dhe, për pasojë, edhe të qëndrueshmërisë dhe efijencës së saj afatgjate.

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës akti mbi të drejtën e informimit konsiderohet si ligji i cili e transformoi administratën amerikane në një administratë me të vërtetë transparente. Në këtë vend, jurisprudenca e së drejtës së informimit është zhvilluar në mënyrë të vrullshme, duke përbërë sot një nga bazat e së drejtës amerikane.

Në Europë, megjithëse më pak se në ShBA, e drejta e informimit po krijon edhe ajo jurisprudencën e saj të gjerë. Disa vende anëtare të Bashkimit European kanë përshtatur ligje të veçanta për rregullimin e kësaj të drejte, ndërkohë që vende të tjera e kanë përmirësuar zbatimin e saj me akte nënligjore. Parlamenti European dhe Këshilli i Europës, mbështetur në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, kanë nxjerrë disa akte në mbështetje të kësaj të drejte, si rekomandime për përshtatjen e tyre në legjislationin e vendeve anëtare.

Mundësia e individëve për të marrë informacion mbi qeverinë e tyre, është thelbësore për demokracinë. Vetëm një publik i mirinformuar është në gjendje të kryejë si duhet obligimin e tij, për t'i dhënë formë politikës, institucioneve politike dhe administratës publike.

Në demokracitë moderne mundësia e publikut për t'u njohur me informacionet shtetërore sigurohet me dy mënyra: Së pari, mbi shtetin janë vënë kufizime, lidhur me mundësinë që ka ai për të censuruar ata që do të jepnin njoftime rreth veprimtarive të tij. Së dyti, ekzistojnë masa ligjore të cilat u japin mundësi individëve të shtien në dorë dokumente shtetërore të llojeve të ndryshme.

Megjithatë, në asnjë rast liria e individit nuk është absolute. Në përgjithësi, ajo mund të kufizohet nga interesi publik dhe nga mbrojtja e interesave të të tretëve. Edhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 17 të saj përcakton dy raste të vetme të kufizimit të kësaj të drejte. Është, gjithashtu, e rëndësishme të përmendim se edhe këto dy raste të kufizimit mund të bëhen vetëm me ligj. Më konkretisht, e drejta për informim mund të kufizohet vetëm nga ligji “Për sekretin shtetëror” dhe nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, mbështetur në parimet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, mbron të drejtën e informimit mbi veprimtarinë e organeve shtetërore, duke e klasifikuar atë, në nenin 23 të saj, si një e drejtë themelore. Në Kushtetutë përcaktohet se kjo e drejtë

rregullohet me ligj. Në fakt, legjislacioni shqiptar, i cili mbron dhe zbaton të drejtën kushtetuese për informim, është më se i kompletuar, duke pasur parasysh që të drejtën për informim e gjejmë në dy ligje të veçanta, me fjalë të tjera në Kodin e Procedurave Administrative (neni 51 deri 55) dhe në ligjin “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”.

Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative mbi të drejtën për t’u informuar fokusohen më shumë në garantimin e informacionit, në rastet kur zhvillohet ndonjë procedim administrativ që ka lidhje të drejtpërdrejtë me një person. E drejta për t’u informuar, kur një person është pjesë e një procedimi administrativ dhe sidomos kur ka procedim ose trajtim të të dhënave të tij vetjake sigurohet, gjithashtu, edhe nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i cili në këtë rast nuk vepron si kufizues, por si garantues i kësaj të drejte. Dispozitat e këtyre dy ligjeve përcaktojnë edhe afatet kohore brenda të cilave duhet bërë njoftimi i personave të interesuar. Në të dyja këto raste informimi i personave të interesuar bëhet duke prezumuar që ato nuk kanë dhe nuk mund të kenë dijeni që ata ose të dhëna që kanë lidhje me ta, janë bërë pjesë e ndonjë procedimi administrativ. Është e qartë që në këtë rast ligjvënësi është i interesuar që e drejta për informim të gëzohet në mënyrë automatike edhe në rastet kur nuk ka kërkesë të veçantë për të marrë informacion. Me këtë përcaktim dua të shpjegoj që ekzistenca e ligjit të veçantë “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”, të cilin do ta shtjelloj më poshtë, nuk është thjesht një përsëritje ose mbivendosje e dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, por një plotësim i tij në rastet kur dëshira për t’u informuar nuk vjen domosdoshmërisht nga ndonjë interes i drejtpërdrejtë.

Ligji “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare” është një zhvillim i mëtejshëm i kësaj të drejte të sanksionuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Me këtë ligj krijohet baza ligjore, praktike dhe procedurale për vënien në jetë të kësaj të drejte. Nga njëra anë, ky ligj ia bën më të qartë publikut rrugët dhe mënyrat për gëzimin e të drejtës kushtetuese

për informim. Nga ana tjetër, ligji i tregon administratës publike mënyrën e punës për të qënë sa më transparente në veprimtarinë e saj.

Objekti i këtij ligji, sipas nenit 1, është përqendruar në rregullimin e së drejtës për informim mbi dokumentet zyrtare. Përqendrimi në këtë drejtim mund të konsiderohet si më i rëndësishëm, për arsye se veçanërisht këtu vërehet edhe mangësia kryesore e mosrealizimit të së drejtës themelore për informim. Aspekte të tjera të kësaj të drejte, si pjesëmarrja në mbledhjet e organeve të zgjedhura, informimi i mediave etj., janë përgjithësisht të rregulluara dhe kanë një nivel më të lartë respektimi në krahasim me informimin mbi dokumentet zyrtare. Gjithashtu, përqendrimi te dokumentet zyrtare përjashton të gjitha ato komunikime ose shkresa brenda zyrave të administratës, të cilat duhet të mbeten të tilla në mënyrë që administrata të punojë pa presion nga jashtë dhe të jetë e aftë të marrë përgjegjësi dhe vendime.

Subjektet që i nënshtrohen këtij ligji janë të gjitha ato subjekte të përcaktuara në nenin 2 me termin “autoritet publik” dhe përfshijnë çdo organ të administratës dhe të enteve publike në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky përcaktim është mbështetur në Direktivën 81 të Këshillit të Europës, e cila ka për qëllim kryesor informimin e publikut jo vetëm nga organet e administratës shtetërore, por edhe nga çdo subjekt tjetër, veprimtaria e të cilëve ka një ndikim mbi publikun. Nuk është bërë ende e qartë që edhe veprimtaria e administratës së gjykatave ose e gjyqësorit në tërësi i nënshtrohet dispozitave të këtij ligji dhe një pohim i tillë shpesh akuzohet pa të drejtë si një shkelje e pavarësisë së gjyqësorit. Megjithatë, transparenca në punën e gjyqësorit është një element shumë i rëndësishëm, për ta bërë atë sa më të përgjegjshëm, si dhe për të luftuar dukuritë korruptive. Nëse një pohim i tillë është i vërtetë për ekzekutivin dhe legjislativin, përse duhet të jetë ndryshe në rastin e gjyqësorit? Në SHBA, ku e drejta e informimit shihet si themeli i demokracisë amerikane, qytetarët mund të informohen me gjithëka bën gjykata dhe deri mbi dosjet gjyqësore, me kusht që gjyqtari



i çështjes ta ketë përfshirë më parë këtë informacion në dosjen gjyqësore. Jo vetëm kaq, por shumica e gjykatave amerikane kanë faqe interneti në të cilat çdo person mund të shohë se çfarë po ndodh me procesimin e çështjeve për të cilat ai është i interesuar.

Është shumë pozitiv fakti që më 3 prill 2001, Ministri i Drejtësisë miratoi “Rregulloren e brendshme të gjykatave”, e cila ka një kre mbi krijimin e zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe mediat. Mund të vihet re se ky kre është hartuar duke pasur si model ligjin “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”. Hartimi i kësaj rregulloreje do të rezultojë në hapjen e sistemit gjyqësor ndaj publikut, në rritjen e transparencës së punës të gjykatave, gjyqtarëve dhe personelit tjetër administrativ, në vënien e gjykatave totalisht në shërbim të publikut, si dhe në përmirësimin e imazhit të sistemit gjyqësor shqiptar.

Është e qartë se tashmë edhe gjyqësori e ka kuptuar rëndësinë e së drejtës për informim, duke qenë jo vetëm garancia përfundimtare për gëzimin e kësaj të drejte, por duke dhënë edhe shembullin vetjak në zbatimin e kësaj të drejte kushtetuese.

Parimet themelore të ligjit janë shprehur në nenin 3. Këto parime janë: e drejta e çdo individit për të kërkuar informacion mbi dokumentet zyrtare, pa qenë i detyruar të japë shpjegime; detyrimi i autoritetit publik të japë informacione mbi dokumentet zyrtare, me përjashtim të rasteve kur ky informacion kufizohet me ligj; si dhe parimi që informacioni i hapur për një person është në parim i hapur për çdo person tjetër.

Në nenin 4 parashikohet që, edhe kur ligji ndalon dhënien e informacionit të kërkuar, autoriteti publik duhet të lëshojë një deklaratë me shkrim, duke shpjeguar arsyet ligjore për një ndalim të tillë. Lëshimi i një deklaratë me shkrim ka shumë rëndësi sepse, së pari, i bëhet e ditur personit arsyja e ndalimit dhe i jepet informacion se si mund të arrijë ta marrë këtë dokument zyrtar dhe, së dyti, ekzistenca e deklaratës me shkrim bën të mundur ankimin. Në rastet kur autoriteti publik nuk lëshon deklaratë, janë

dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative të cilat lejojnë ankimin në gjykatë edhe pa këtë deklaratë. Gjithashtu, është për t'u lavdëruar edhe jurisprudenca e krijuar nga një vendim precedent i Gjykatës së Lartë, e cila autorizon ankimin edhe në rastet kur autoriteti publik nuk vepron me lëshimin e deklaratës së mospranimit. Në praktikë jo të gjitha informacionet që përmban një dokument zyrtar janë sekrete, për këtë arsye paragrafi i dytë i nenit 4 përcakton detyrimin e dhënies së asaj pjese të dokumentit për të cilën nuk ka ndalim.

Neni 5 siguron informimin për personat e veshur me pushtet shtetëror. Ky nen është hartuar duke mbajtur parasysh ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe vendos një barazpeshim midis të dhënave vetjake të këtyre personave dhe asaj pjese të të dhënave që lidhen me cilësitë e tyre si persona që kryejnë funksione shtetërore. Ky nen mënjanon mosdhënien e informacionit me justifikimin se ai përbën të dhëna vetjake të këtyre personave.

Nenet 6 dhe 7 kanë të bëjnë përkatësisht me cilësinë e shërbimit të informacionit dhe formën në të cilën jepet informacioni. Neni 6 përcakton detyrimin e autoritetit publik, për të krijuar të gjithë infrastrukturën e nevojshme në mënyrë që informacioni i kërkuar të jepet i saktë, i plotë dhe në një kohë sa më të shkurtër. Sipas nenit 7 forma e dhënies së informacionit do të zgjidhet nga vetë kërkuesi.

Sipas këtij ligji, dokumentet zyrtare ndahen në 3 kategori. Në nenin 8 kemi kategorinë e parë të dokumenteve zyrtare. Këto janë dokumente që kanë të bëjnë me adresën e zyrave të autoritetit publik, rregulloret e marrëdhënieve me publikun dhe shpjegime për metodat dhe procedurat e punës së autoritetit publik. Këto informacione duhet të jenë të gatshme dhe të shpallen publikisht edhe pa pasur ndonjë kërkesë të veçantë. Neni 9 përcakton ato dokumente të cilat nuk është e nevojshme të shpallen, por duhet të përgatiten paraprakisht dhe të jenë gati në rast të ndonjë kërkesë nga publiku. Kategoria e tretë përfshin të gjitha dokumentet e tjera zyrtare.

Një nga aspektet më të rëndësishme të këtij ligji është edhe vendosja e afateve për realizimin e kërkesës së publikut për informacion mbi dokumentet zyrtare. Sipas nenit 10, afati për pranimin ose mospranimin e kërkesës është 15 ditë dhe, në rast të një përgjigjeje negative, kjo e fundit duhet të jetë me shkrim dhe e arsyetuar. Afati për përgjigje, sipas nenit 11, është lënë 40 ditë, duke parashikuar në nenin 12 dhe mundësinë e shtyrjes në afat në rastet kur për arsye objektive, që janë veçantia e kërkesës ose nevoja për të këshilluar një palë të tretë, autoriteti publik e ka të pamundur përmbushjen e kërkesës brenda afatit 40-ditor.

Natyrisht, shërbimi i informimit ka dhe kosto. Neni 13 përcakton pagesat për këtë shërbim. Dokumentet zyrtare, që sipas nenit 8 shpallen publikisht, janë pa pagesë. Për të gjitha shërbimet e tjera autoriteti publik mund të vendosë tarifa të cilat nuk duhet të jenë më të larta se kostoja e drejtpërdrejtë e nevojshme për realizimin e shërbimit të informimit. Tarifat vendosen paraprakisht dhe vendimet për përcaktimin e tyre përbëjnë në vetvete një dokument zyrtar të hapur për publikun.

Ligji përcakton edhe mjetet me të cilat individët që pretendojnë se u është shkelur kjo e drejtë, mund ta realizojnë atë. Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, personi i interesuar mund të ankohet në rrugë administrative, sipas Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në rrugë gjyqësore. Gjithashtu, ligji i referohet edhe Avokatit të Popullit. Kjo referencë në fakt është vetëm një kujtesë për Avokatin e Popullit, sepse natyrisht edhe pa këtë ligj ky i fundit ka kompetencë të ndërhyjë në rastet kur shkelet e drejta për informim.

Deri tani asnjë kërkesë e këtij ligji, si për shembull, krijimi i lehtësirave strukturore e praktike për marrjen e informacionit nga publiku, hartimi dhe shpallja e dokumenteve zyrtare, që vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë, nuk janë zbatuar nga asnjë autoritet publik. Ligji për të drejtën e informimit ka hyrë në fuqi që në shkurt të vitit 2000, por mund të them që për zbatimin e tij është bërë pak ose aspak. Jo më kot legjislatori la një afat 6-mujor pas

botimit në Fletoren Zyrtare për hyrjen në fuqi të këtij ligji. Sipas nenit 6 të këtij ligji, autoritetet publike duhet të nxirrin rregullore dhe gjithashtu, të krijojnë lehtësira strukturore e praktike për marrjen e dokumenteve zyrtare nga administrata. Me sa di unë, jo vetëm që autoritetet publike nuk kanë nxjerrë ndonjë rregullore, por është ende problem edhe akses i publikut në zyrat e tyre. Edhe në rastet kur ky akses sigurohet (në shumicën e rasteve nëpërmjet kangjellave të ndonjë kioske), publiku gjendet përballë një personeli të pakualifikuar, të pasjellshëm dhe të korruptuar.

Së fundi, shpresoj që ky ligj kaq themelor do të fillojë të zbatohet në të gjitha aspektet e tij dhe nuk do të vazhdojë të mbetet, si shumë ligje të tjera, në fondin e ligjeve të vdekura shqiptare. Le të japim një shembull për rëndësinë shoqërore dhe mundësitë e këtij ligji. Besoj se të gjithë e kanë ndjekur emisionin televiziv “Ajzberg”. Shumëkush pyeste se si arrinte gazetari të gjente gjithë ato dokumente, për të denoncuar akte me natyrë korruptive. Natyrisht një pjesë të meritës e ka vetë zotësia e këtij gazetari, por mund të them se të gjitha dokumentet që ai paraqiste ishin dokumente zyrtare të marra në rrugë të ligjshme falë ligjit “Për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare”.

# Korniza kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme në Kosovë

## *Kuptimi i kornizës kushtetuese*

*Prof.dr.Arsim Bajrami*

*Profesor i së Drejtës Kushtetuese në*

*Fakultetin Juridik në Prishtinë*

Shprehja “kornizë kushtetuese” është pak e njohur në teorinë dhe praktikën kushtetuese. Në esencë, fjala kornizë nënkupton limitet, përkatësisht kufinj të brenda të cilit rregullohet një materie e caktuar. Nisur nga kjo, emërtimi “kornizë kushtetuese” do të përfshinte parimet e përgjithshme të rregullimit të një materieje jo kushtetuese. Megjithatë, ky akt është i natyrës konstitucionale dhe synon të përcaktojë bazat e rendit kushtetues të Kosovës në periudhën e administrimit ndërkombëtar.

Miratimi i Kornizës Kushtetuese ka filluar procesin e ndërtimit të institucioneve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë. Njëkohësisht, me këtë akt fillon themelimi i vetëqeverisjes së përkohshme për Kosovën dhe bartja progresive e përgjegjësisë nga autoritetet ndërkombëtare, në institucionet vendore demokratike, të themeluara në zgjedhjet e lira.

Baza juridike për nxjerrjen e kësaj Kornize Kushtetuese, është përcaktuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që parasheh ushtrimin e një qeverisjeje të mirëfilltë (substanciale) për Kosovën gjatë periudhës kalimtare. Pra, edhe ky akt, sikur edhe Rezoluta 1244, ka karakter të përkohshëm dhe do të vlejë deri në nxjerrjen e një rezolute të re nga KS i OKB-ës ose gjer në gjetjen e zgjidhjes finale statusore për Kosovën. Është

interesant, se Korniza Kushtetuese, duke përcaktuar parimet politike dhe juridike të statusit të Kosovës, i referohet Marrëveshjes së Rambujes, që paraqet një absurd juridik, kur dihet se ajo nuk është nënshkruar nga palët negociuese dhe, si e tillë, nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Në anën tjetër, referimi te kjo Marrëveshje, për rrethanat e reja (të krijuara pas genocidit serb në Kosovë), nuk është real, sepse tani kemi realitete faktike, të cilat duhet të avancojnë zgjidhjet juridike dhe politike.

Korniza Kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme ka tri qëllime kryesore:

1. Krijimin e bazës juridike për mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare dhe për krijimin e institucioneve legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore në nivel të Kosovës;

2. Vendosjen e vetëqeverisjes së përkohshme për Kosovën, brenda kornizës së përcaktuar me Rezolutën 1244 për periudhën kalimtare; dhe

3. Përgatitjen e Kosovës për zgjidhjen politike, proces ky që është për një bazë të mëvonshme, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar, të përcaktuar me Rezolutën 1244.

## ÇËSHTJET KONTESTUESE ME RASTIN E HARTIMIT TË KORNIZËS KUSHTETUESE

Procesi i miratimit të Kornizës Kushtetuese ka qenë mjaft i ndërlikuar dhe është karakterizuar me mospajtueshmëri rreth disa zgjedhjeve kushtetuese. Teksti i Kornizës është hartuar nga grupi i përbashkët prej 15 ekspertësh ndërkombëtarë dhe vendorë. Hartimi i Kornizës nuk ka qenë vetëm një proces i thjeshtë i shkruarjes së një kushtetute, por ka pasur edhe mjaft elemente të negociatave politike rreth gjerësisë së qeverisjes, strukturës institucionale të saj, kompetencave të organeve etj., që duhet të ketë Kosova në fazën kalimtare.

Në këtë proces, ka qenë i përfshirë drejtpërdrejtë edhe Këshilli i

Përkohshëm Administrativ (KPA), i cili me shumicë votash ka bërë miratimin politik të Kornizës Kushtetuese, të cilën e ka nënshkruar dhe shpallur PSSP.

Ekspertët kosovarë të cilët kanë marrë pjesë në Grupin e Përbashkët, kanë insistuar në gjashtë kërkesa kryesore:

1. *Kërkesa që Kosova edhe gjatë administrimit ndërkombëtar të ketë një kushtetutë të përkohshme.* Kjo, ngase Rezoluta 1244 nuk e kundërshton të drejtën e Kosovës për ta pasur kushtetutën si akt më të lartë politik dhe juridik. Në anën tjetër, Kosova kishte një traditë kushtetuese, që nga viti 1969, 1974, 1990 (Kushtetuta e Kaçanikut). Madje, edhe në Konferencën e Paqes të mbajtur në Rambuje për Kosovën parashihej të ketë një kushtetutë kalimtare për periudhën trevjeçare. Të gjitha këto argumente, të cilat u shtruan mjaft profesionalisht, nuk u morën parasysh nga UNMIK-u dhe dokumenti u emërua si Kornizë Kushtetuese. Autoritetet ndërkombëtare në Kosovë emërtimin e dokumentit si “kushtetutë” e kualifikonin si element që prejudikon statusin përfundimtar të Kosovës. Ky qëndrim nuk është i qëndrueshëm, sepse praktika konstitucionale vërteton se shumë entitete, edhe pse nuk ishin shtete me subjektivitet ndërkombëtar, kishin kushtetutat e tyre. Raste të tilla edhe sot hasen në shumë shtete federative. Së fundi, Kosova edhe në kohën kur nuk ishte shtet i pranuar ndërkombëtarisht (1969, 1974, 1990) kishte kushtetutën e saj.

2. *Kërkesa për garantimin kushtetues lidhur me referendumin, përkatësisht shprehjen e lirë të vullnetit të popullit të Kosovës për statusin përfundimtar të Kosovës.* Pra, fjala është për garantimin kushtetues, se zgjidhja përfundimtare për Kosovën do të bazohet në vullnetin e popullit të Kosovës. Kjo kërkesë ishte e propozuar nga ekspertët kosovarë dhe përkrahej nga opinioni i gjerë i Kosovës. Edhe pse u dha një argumentim, se kjo kërkesë është legjitime dhe në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e njohura për të drejtën e vetëvendosjes së popujve, ajo nuk hasi në mirëkuptim të UNMIK-ut dhe nuk është inkorporuar në tekstin e

Kornizës Kushtetuese. Autoritetet ndërkombëtare konsideronin se kjo kërkesë bie ndesh me Rezolutën 1244 dhe prejudikon statusin përfundimtar. Kjo nuk është e qëndrueshme nga fakti se referendumi paraqet instrumentin më të vjetër të demokracisë, që nga Greqia Antike e deri te demokracitë moderne, të cilat njohin dhe zbatojnë këtë institucion. E dyta, referendumi ka qenë instrumenti me të cilin të gjitha ish-republikat jugosllave (me përjashtim të Malit të Zi) shpallën pavarësinë dhe morën njohjen ndërkombëtare. Edhe Kosova, pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, mbajti referendumin, me të cilin deklaroi pavarësinë, që nuk mori njohjen ndërkombëtare. Në Konferencën e Rambujes ishte pikërisht klauzola për referendumin vendimtar me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes nga delegacioni shqiptar.

Është interesat se argumentet kryesore të autoriteteve ndërkombëtare kundër kërkesës për referendum bazohen në dy fakte kryesore: *E para*, se dhënia e këtij garancioni kushtetues do të prejudikonte statusin final të Kosovës dhe, *e dyta*, teoria e re që tani po promovohet për rrezikshmërinë e referendunit në shtetet e tranzicionit, sidomos për shoqëritë e reja me përbërje shumetnike.

Do të hedhim argumente juridike dhe politike, të cilat vërtetojnë paqëndrueshmërinë e këtyre konstatimeve:

Pohimi, se përcaktimi i referendunit në Kornizën Kushtetuese është në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe se kjo do të prejudikonte statusin final, nuk është i qëndrueshëm. Kërkesa për referencën për marrjen për bazë të vullnetit të popullit (referendunit) ka të bëjë me një periudhë të ardhshme, kur do të shtrohej zgjidhja përfundimtare dhe jo për periudhën kalimtare deri sa Kosova do të jetë nën administrimin ndërkombëtar. Pra, ideja e referendunit ka konsistuar në kërkesën, që kur të gjendet zgjidhja përfundimtare e statusit kushtetues dhe politik (që sigurisht do të jetë një proces ndërkombëtar), të merret për bazë vullneti i popullit të Kosovës, i cili do të shprehej përmes referendunit. Ky referendum, për shkak të pranisë



aktuale ndërkombëtare në Kosovë, do të mund të ishte ndërkombëtar, pra të shpallet, të udhëhiqet dhe të mbikqyret nga autoritetet ndërkombëtare. Kërkesa për garantimin kushtetues, për mbajtjen e referendumit me rastin e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën, nuk është në kundërshtim me Rezolutën 1244. Kjo Rezolutë, duke përcaktuar vetëqeverisjen e përkohshme edhe vetë është në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare për Kosovën. Edhe Marrëveshja e Rambujes, të cilës i referohet Rezoluta 1244, ishte e karakterit të përkohshëm trevjeçar dhe përcaktonte referendumin si pjesë konstituive të zgjidhjes finale për statusin e Kosovës. Autoritetet ndërkombëtare nuk e kanë kuptuar drejt një kërkesë të tillë. Madje ka pasur edhe keqkuptime, duke krijuar opinionin se referendumi kërkohet për periudhën kalimtare, derisa Kosova ndodhet nën administrimin ndërkombëtar në bazë të Rezolutës 1244.

Argumentimi i dytë, i cili është potencuar kundër përfshirjes së referendumit në Kornizën Kushtetuese, konsiston në teorinë, që tani po promovohet për gjoja rrezikshmërinë e referendumit në shtetet e Europës Lindore dhe përvojën e ish-republikave jugosllave, të cilat pas referendumeve për pavarësi, u ndeshën me agresionin dhe luftën e Serbisë, në realizimin e aspiratës për liri dhe pavarësi. Si fakt tjetër theksohet se referendumi është i rrezikshëm për demokracitë e reja, sidomos për ato që nuk janë homogjene në pikëpamje etnike dhe se mundëson majorizimin, përkatësisht mbivotimin e pakicave. Në vend të referendumit, me këtë rast favorizohen instrumentet e demokracisë përfaqësuese (parlamentare), pra marrja e vendimeve nga parlamenti, qeveria etj. Një teori e tillë bie ndesh edhe me praktikën ndërkombëtare, e cila është në favor të përdorimit të referendumit. Këtë e vërtetojnë referendumet e shpeshta të shteteve europiane për integrimin e tyre në Bashkimin Europian, si dhe referendumet kombëtare për çështjet e ndryshme, në anën tjetër, praktika ka vërtetuar se shumica e shteteve të Europës Lindore, sidomos ato të Ballkanit, përmes referendumit kanë përcaktuar statusin e tyre dhe kanë hyrë në fazën e tranzicionit.

Në bazë të këtyre argumenteve, mund të konkludojmë se kërkesa për referendum është kërkesë legjitime e shqiptarëve të Kosovës, në pajtim të plotë me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe dokumentet tjera ndërkombëtare, të cilat njohin dhe garantojnë të drejtën e vetëvendosjes së popujve. Zgjidhja politike e statusit final për Kosovën, përmes referendumit dhe deklarimit të drejtëpërdrejtë të qytetarëve të saj, është një zgjidhje demokratike, e cila do t'i jepte fund krizës në Kosovë dhe do të krijonte stabilitetin në rajon dhe më gjerë.

Përkundër argumentimit të bollshëm profesional, autoritetet ndërkombëtare refuzuan kërkesën e ekspertëve kosovarë (të cilët kanë dhënë tri kërkesa për referendumin) për një referim eksplicit të referendumit. Në vend të kësaj, në preambulën e Kornizës Kushtetuese, është dhënë një referim për marrjen parasysh të vullnetit të popullit në pajtim me Rezolutën 1244 dhe faktorë të tjerë. Ky formulim përcakton se Korniza kushtetuese, duke transferuar përgjegjësitë tek institucionet e përkohshme të vetëqeverisjes, thekson se kjo bëhet *“me qëllim për të lehtësuar përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, nëpërmjet një procesi gjatë një faze të ardhshme të përshtatshme në pajtim me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, i cili do të marrë parasysh vullnetin e popullit dhe të gjithë faktorët e tjerë.”*

Një formulim i tillë nuk përcakton referendumin si instrument i përcaktimit të statusit final të Kosovës. Referenca që është dhënë për *“marrjen parasysh të vullnetit të popullit dhe të gjithë faktorëve të tjerë”*, e deplason idenë e referendumit, duke e lidhur mbajtjen e tij me Rezolutën 1244 dhe përcaktimet e saj juridike dhe politike.

Një kufizim i këtillë i referendumit e kufizon deklarimin e vullnetit të popullit, sepse ai në formulimin që është dhënë kushtëzohet me Rezolutën 1244, që për Kosovën parashihej një vetëqeverisje (autonomi) substaciale brenda *“RF të Jugosllavisë”*. Për një deklaram të këtillë populli i Kosovës

nuk ka nevojë, pasi që pikërisht qenia e dhunshme e Kosovës në kuadrin e RF të Jugosllavisë ishte burim i krizës dhe shkak i luftës çlirimtare për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Mendojmë se referendumi do të duhej të ndahej plotësisht nga Rezoluta 1244. Ky mekanizëm, do të duhej zbatuar me rastin e zgjidhjes përfundimtare statusore për Kosovën. Pra, atëherë, kur edhe vetë autoritetet ndërkombëtare do të vlerësojnë se janë krijuar kushtet për gjetjen e zgjidhjess përfundimtare për Kosovën. Me arritjen e këtij procesi do të pushonte së funksionuari Rezoluta 1244 dhe do të kalohej në një fazë shumë më të avancuar të procesit politik - pra në fazën e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën. Në këtë fazë referendumi do të ishte elementi konstitutiv i zgjidhjes finale. Themi element konstitutiv, sepse mekanizmi i zgjidhjes finale (i cili nuk është përcaktuar as me Rezolutën 1244) (të citohet mekanizmi i Rambujes që përcakton mbajtjen e Konferencës ndërkombëtare), sigurisht do të jetë mjaft i komplikuar dhe do të involvojë faktorin ndërkombëtar, por edhe palët e interesuara në rajon. Në këtë proces, referendumi do të mund të vinte në shprehje në dy rrethana: E para, pas përfundimit të administrimit ndërkombëtar dhe kryerjes së misionit të përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Në këtë rast, Kombet e Bashkuara, para tërheqjes së tyre nga Kosova, do të mund të shpallnin referendumin për statusin final të Kosovë dhe të udhëhiqnin realizimin e tij. Një veprim i këtillë, do të ishte legjitim dhe demokratik, sepse në mënyrë të drejtëpërdrejtë, në bazë të deklaramit të qytetarëve të Kosovës, do të zgjidhej statusi politik i Kosovës. Rrethana e dytë, do të vinte në shprehje po qe se zgjidhja përfundimtare do të ishte rezultat i ndonjë procesi ndërkombëtar (konferencë ndërkombëtare, marrëveshje ndërkombëtare). Edhe në këtë rast, zgjidhja politike ndërkombëtare do të duhej akceptuar nga populli i Kosovës me referendum. Pra, edhe në rastin e dytë, referendumi do të ishte me karakter konstitutiv e vendimtar dhe nga rezultati i tij do të varej zgjidhja përfundimtare politike për Kosovën.

Korniza Kushtetuese, duke mos akceptuar kërkesën e ekspertëve kosovarë për një garancim më eksplicit kushtetues për mbajtjen e referendumit për statusin final të Kosovës, ka bërë një interpretim dogmatik dhe mjaft të kufizuar të Rezolutës 1244. Duke pasur parasysh rrethanat e reja të krijuara në Kosovë, tri vite pas miratimit të Rezolutës 1244, pra avancimin e rrethanave politike dhe krijimin e realiteteve të reja, është pritur që kjo Kornizë të bëjë një interpretim më kreativ të kësaj Rezolutive, duke avancuar zgjidhjet politike, të cilat do të mënjanonin shumë paqartësi dhe kontraverza, që ndërthën në vete kjo Rezolutë. Në këtë kontekst, garancioni për referendumin në periudhën e mëvonshme nuk ka qenë në kundërshtim me vetë Rezolutën 1244, e cila siç dihet është akt i përkohshëm, në pritje të një zgjidhjeje përfundimtare. Së fundi, shumë zgjidhje kufizuese kushtetuese, që Korniza Kushtetuese përcakton në sistemin e qeverisjes, të cilën do ta ushtrojë Kosova në periudhën kalimtare, si dhe pushteti që do të ngel në autoritetin e PSSP-së, do të ishin të përkohshme dhe do të pranoheshin më lehtë nga qytetarët e Kosovës, sikur ata të merrnin garancionin se zgjidhja finale do të jetë demokratike dhe do të marrë parasysh vullnetin e popullit, që do të shprehej në referendum. Megjithatë, na mbetet të shpresojmë, se në proceset politike, të cilat do të zhvillohen pas zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare, përmes amendamenteve kushtetuese, Kuvendi i Kosovës do të mund të inkorporojë referendumin si pjesë të Kornizës Kushtetuese.

3. *Struktura e plotë institucionale për Kosovën* ishte kërkesë tjetër e ekspertëve kosovarë me rastin e hartimit dhe të miratimit të Kornizës Kushtetuese. Kosova, edhe gjatë periudhës kalimtare, ka mundur të ketë të gjitha institucionet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Pra, Kuvendin, Qeverinë, Krytarin, Gjykatën Kushtetuese, sistemin e plotë të gjyqësisë dhe organet dhe institucionet tjera. Korniza Kushtetuese parasheh këto organe të Kosovës: Kuvendin, Qeverinë, Kryetarin, Gjykatën Supreme dhe organet e tjera të gjyqësisë. Në vend të Gjykatës Kushtetuese është paraparë formimi

i një kolegji të posaçëm për mbrojtjen e Kornizës Kushtetuese. Edhe pse Korniza Kushtetuese në Parimet Themelore proklamoi parimin e ndarjes dhe ballansit midis tri pushteteve, dispozitat kushtetuese kanë lënë në autoritetin e PSSP-së mjaft çështje nga kompetenca e këtyre organeve, të cilat atë e bëjnë të jetë autoritet përfundimtar në sferën legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore. Autorizimet e tij janë mjaft të gjera dhe autoriteti i tij, që buron nga rezoluta 1244, nuk është kufizuar me Kornizën Kushtetuese. Ai ka të drejtë të shpërndajë Kuvendin, të shpallë ligjet, të përdorë të drejtën e vetos ndaj ligjeve të Kuvendit, të emërojë dhe të shkarkojë gjyqtarët dhe prokurorët, si dhe një mori kompetencash të tjera, të cilat janë tipike për pushtetet presidenciale. E tërë kjo vërteton se vetëqeverisja, të cilën do ta ketë Kosova gjatë periudhës kalimtare, jo vetëm që do të jetë e kufizuar me elementet shtetërorë, por edhe e mbikëqyrur dhe e kontrolluar nga PSSP-ja. Kjo do të thotë se, në vend të një koncepti të një qeverisjeje efektive dhe funksionale, megjithatë Korniza Kushtetuese përcakton një koncept të qeverisjes së kontrolluar, e cila duhet të jetë në përputhje me Rezolutën 1244.

4. Korniza Kushtetuese edhe pse paraqet një akt të përkohshëm juridik *nuk është kufizuar në pikëpamje kohore*. Kërkesa për të caktuar kohëzgjatjen e periudhës kalimtare, pra edhe të administrimit ndërkombëtar, nuk është pranuar nga autoritetet ndërkombëtare. Si arsye për këtë ata theksojnë se edhe Rezoluta 1244 nuk është e limituar në pikëpamje kohore dhe ajo do të vlejë gjerë në nxjerrjen e ndonjë rezolute tjetër të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që do ta shfuqizojë atë, ose deri në përcaktimin e zgjidhjes përfundimtare për Kosovën.

Përkundër këtij kufizimi legal, mendojmë se ka mundur që me Kornizën Kushtetuese të përcaktohet periudha trevjeçare e vlefshmërisë së saj, duke pasur parasysh se edhe kohëzgjatja e mandatit të organeve të Kosovës (Kuvendit, Qeverisë dhe Kryetarit) është tre vjet. Limiti kohor i Kornizës Kushtetuese nuk do të thotë edhe limiti i administrimit ndërkombëtar në

Kosovë. Mendohet se periudha prej tre viteve është e mjaftueshme për të përgatitur kushtet për një zgjidhje përfundimtare për Kosovën.

## Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend

*Filip Lako*  
*Jurist*

**Ligj nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.** Ky ligj përcakton rregullat për themelimin, regjistrimin, funksionimin, organizimin dhe veprimtarinë e organizatave jofitimprurëse, të cilat ndjekin qëllime në të mirë dhe në interes të publikut. Themelimi, format, organizimi, funksionimi dhe fusha e veprimtarisë së organizatave jofitimprurëse bëhet në përputhje me Kodin Civil dhe me ligjin e lartpërmendur. Sipas parimeve të përgjithshme të ligjit, çdo person fizik ose juridik, vendas ose i huaj, ka të drejtë të themelojë një organizatë jofitimprurëse, të jetë anëtar i saj ose të marrë pjesë në organet drejtuese ose në personelin administrativ të organizatës jofitimprurëse. Ligji bën ndarjen e organizatave jofitimprurëse sipas organizimit dhe sipas të drejtës, jep mënyrën e themelimit dhe të regjistrimit të tyre, organizimin dhe funksionimin, të drejtat e organizatave jofitimprurëse të huaja, duke përcaktuar edhe dokumentet e nevojshme për regjistrimin e tyre etj. Gjithashtu, rregullim në ligj gjejnë edhe problemet e licencimit, të të ardhurave dhe të veprimtarisë ekonomike, si dhe ato të transformimit, bashkimit, ndërprerjes së veprimtarisë dhe të shpërndarjes. Me miratimin e këtij ligji shfuqizohet ligji nr.7695, datë 7.4.1993 “Për fondacionet”. Ligji ka 52 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 të vitit 2001, faqe 857.

**Ligj nr.8789, datë 7.5.2001 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.** Ky ligj përcakton procedurat e regjistrimit të organizatave jofitimprurëse, si dhe rregullat për mbajtjen e regjistrit të tyre. Rregullon problemet që kanë të bëjnë me veprimet e Sekretarit të Regjistrit, me publikimin e njoftimeve ligjore etj. Në mënyrë të detajuar janë dhënë forma dhe përmbajtja e regjistrit lidhur me dosjet, skedarët, datën e regjistrimeve, ndryshimin e tyre, korrigjimet etj. Vendimi për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse, si dhe çdo vendim tjetër, lidhur me veprimet që lidhen me regjistrimin e tyre, kryhen nga një gjyqtar i seksionit tregtar të gjykatës. Regjistri i Organizatave Jofitimprurëse mbahet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës. Ligji ka 41 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.28 të vitit 2001, faqe 872.

**Ligj nr.8790, datë 10.5.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”.** Me këtë ligj ndryshohen krejt nenet 2, 3, 17 dhe paragrafi i parë i nenit 16. Në nenin 6 bëhen shtesa e ndryshime, kurse vetëm shtesa janë nenet 2/a, 3/a dhe shtesa të pjesshme kanë nenet 8, 11, 12, 15, 26, 35, 49, 54, 65 e 71. Në të gjitha nenet e ligjit ku shkruhet fjala “rreth” të zëvendësohet me fjalët “rreth gjyqësor”. Rregullime të rëndësishme bëhen sidomos në nenin 2, në lidhje me kushtet për t’u bërë noter dhe në nenin 3 që ka të bëjë me kualifikimin. Edhe shtesat, sidomos nenet 2/a dhe 3/a, rregullojnë, i pari probleme në lidhje me stazhin që duhet të bëjë kandidati për noter, dhe i dyti (neni 3/a) në lidhje me asistencën, domethënë për punën e kandidatit për noter pranë një noteri të caktuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve. Sipas kësaj shtese, në përfundim të periudhës së asistencës, asistenti pajiset me certifikatë të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterëve, pasi merret edhe vlerësimi me shkrim i noterit pranë të cilit asistenti ka punuar. Shtesat dhe ndryshimet e tjera e bëjnë më të plotë, më të saktë e më të qartë ligjin ekzistues. Ligji ka 19 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.29 të vitit 2001, faqe 889.



**Ligj nr.8791, datë 10.5.2001 “Për miratimin e “Marrëveshjes së Konkensionit të formës “ROT” të Minierës së Kromit Bulqizë, të Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, të Impiantit të Seleksionimit Klos dhe të Uzinës së Ferrokromit Burrel ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Shoqërisë Italiane të së Drejtës “DARFO” S.P.A., si dhe dhënies së disa stimuljeve dhe garancive për konkensionerin e kësaj Marrëveshjeje”**”. Kjo Marrëveshje ka për objekt të legjitimojë dhënien në konkension të Minierës së Kromit Bulqizë, Fabrikës së Pasurimit Bulqizë, Impiantit të Seleksionimit Klos dhe Uzinës së Ferrokromit Burrel, Aneksi 1, që organi shtetëror i Autorizuar (OSHA), i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, ia beson konkensionerit për të realizuar rehabilitimin, financimin, administrimin dhe shfrytëzimin e këtij objekti. Sipas këtij ligji, Shoqëria Konkensionare (tregtare), e themeluar prej palës konkensionare përjashtohet nga detyrimet e pagesës së taksave doganore dhe TVSH-së për makineritë, linjat, pajisjet e materialet e tjera që do të përdoren për investime për periudhën e investimit prej 8 vjetësh. Ligji detyron Këshillin e Ministrave që me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Konkensionit të trajtojë detyrimet ndaj shtetit, ndaj sigurimeve shoqërore dhe të tretëve që ka shoqëria tregtare “ALBKROM” sh.a., Tiranë për objektet që jepen në konkension. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 22.5.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.29 të vitit 2001, në faqen 893. Bashkëlidhet Marrëveshja e Konkensionit.

**Ligj nr.8792, datë 10.5.2001 “Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të dhënave”**. Me këtë ligj krijohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Qendra e Përpunimit të të Dhënave, si dhe përcaktohen rregulla për sistemin e trajtimit të informatizuar të të dhënave që kanë të bëjnë me veprimtarinë operative të zyrave qendrore e vendore të Policisë së Shtetit. Ligji rregullon organizimin e qendrës, përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit e të zëvendës drejtorit, kushtet paraprake të futjes së të

dhënave, ruajtjen e hyrjes së të dhënave, transmetime jashtë shtetit të të dhënave dhe informacioneve, përdorimin e informacionit, të drejtën për ankim, krijimin e bankës së të dhënave etj. Në kuptim të ligjit, “banka e të dhënave është tërësia e të dhënave dhe e informacioneve për personat dhe sendet, e organizuar sipas disa kritereve që lehtësojnë trajtimin e tyre dhe, në rast se ndonjë person komunikon ose i përdor të dhënat dhe informacionet e bankës së të dhënave të policisë në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Ligji ka 18 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2001, faqe 909.

**Ligji nr.8793, datë 10.5.2001 “Për parashkrimin e kamatëvonesave të kontributeve të paderdhura për sigurimet shoqërore”.** Me ligjin e lartpërmendur, të gjitha ndërmarrjet shtetërore dhe shoqëritë tregtare me kapital tërësisht shtetëror, nuk do të paguajnë kamatëvonesat e kontributeve për sigurimet shoqërore, të papaguara deri në datën 31.12.2000. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2001, faqe 914.

**Ligji nr.8794, datë 10.5.2001 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000”.** Ligji nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” ka pasur disa shtesa e ndryshime shumë të rëndësishme, si me ligjin nr.8655, datë 31.7.2000, ashtu edhe me këtë ligj. Kështu, ligji nr.8794, datë 10.5.2001 ndryshon 10 nene dhe konkretisht nenet 7, 10, 11, 17, 20, 42, 75, 112 dhe 126, bën shtesa në nenet 7, 10, 14, 43, 73, 85, 119, 129, 137 dhe shfuqizon nenin 23. Ndryshimet kanë të bëjnë kryesisht me administrimin e spektrit të radiofrekuencave nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, me organizimin dhe funksionimin e KKRT-së, llojet e licencave, tarifrat për marrjen e rinovimin e licencave etj. Shtesat lidhen

me kompetencat e Kryetarit të KKRT-së, me disa dispozita të ligjit për të drejtën e autorit dhe mënyrën se si ato duhet të zbatohen për këtë ligj, me shtimin e sanksioneve për shkelje të dispozitave të këtij ligji etj. Gjithashtu, ligjit i shtohet lidhja 1 që ka të bëjë me masën e pagesave vjetore për licencë për radiot dhe televizionet vendore dhe kombëtare. Ligji ka vetëm një shfuqizim dhe ky bëhet për pikën 5 të nenit 23. Ligji nr.8794, datë 10.5.2001 ka 21 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.34 të vitit 2001.

**Ligj nr.8795, datë 14.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Export Credit Bank të Turqisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë për riskedulimin e borxhit”.** Me anën e kësaj marrëveshjeje, Qeveria e Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave të Shqipërisë dhe Export Credit Bank e Turqisë bien dakord të riskedulojnë borxhet që rrjedhin nga Marrëveshja e Kredisë e datës 1.2.1991. Kjo marrëveshje është nënshkruar ndërmjet Turk Eximbank dhe Bankës së Shtetit Shqiptar për Marrëdhëniet me Jashtë. Me këtë Marrëveshje Riskedulimi, Qeveria e Republikës së Shqipërisë merr përsipër të gjitha detyrimet financiare prej 17.574,769 USD, që rrjedhin nga Marrëveshja e Kredisë dhe nga Lehtësirat e Sigurimit (Insurance Facility). Shuma prej 17.574.769.22 USD e riskeduluar përbëhet nga 13.865.328.3 USD që është shuma e papaguar e principalit, nga 719.444.74 USD, që është shuma e interesit të papaguar e Turk Eximbank-ut për Lehtësirat e Sigurimit (Insurance Facility). Shuma prej 17.574.769.22 USD do të paguhet me 21 këste të njëpasnjëshme gjashtëmujore. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.30 të vitit 2001, faqe 915. Bashkëlidhet Marrëveshja.

**Ligj nr. 8799, datë 17.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës**

**Islamike të Zhvillimit për projektin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në Fushë-Krujë dhe Peshkopi**". Qëllimi i projektit është të përmirësojë sistemin sanitar të furnizimit me ujë në qytetet e Fushë - Krujës dhe të Peshkopisë nëpërmjet përmirësimit dhe zgjerimit të sistemit të ujësjellës-kanalizimeve dhe gjetjes së burimeve të reja. Projekti përfshin punët publike, supervizionin e shërbimit e konsulencës. Punët publike janë në formën e shtrirjes dhe të furnizimit të rrjetit të ujësjellësve, rrjetit të kanalizimeve, ndërtimit të rezervuarëve të ujit, klorinimit të tij, stacioneve të pompimit, hapjes së puseve të ujit dhe zhvillimit të burimeve ujore, furnizimit dhe instalimit të matësve të ujit, shërbimet e kanalizimeve dhe punët e tjera publike. Huaja do të jetë në një shumë jo më tepër se ekuivalentja e 4.990.000 Dinarë Islamikë, dhe huamarrësi do të kthejë shumën e huasë brenda 25 vjetëve. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 30.6.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.34 të vitit 2001, faqe 1063. Bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë.

**Ligji nr.8800, datë 17.5.2001 "Për ratifikimin e "Amendamentit të Marrëveshjes së Huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit për projektin e furnizimit të fshatrave me ujë të pijshëm"**. Marrëveshja e Huasë ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Islamike të Zhvillimit është bërë më 7.10.1996. Me këtë ligj miratohen disa amendamente që i janë bërë kësaj marrëveshjeje, duke e plotësuar dhe saktësuar më mirë. Amendamentet bëhen tek tabelat e pagesave pjesore dhe pagesave të shërbimit. Gjithashtu, ndryshime ka edhe tek përshkrimi i projektit, sipas të cilit do të sigurohen me ujë të pijshëm nga burimet natyrore 29 fshatra dhe 3 qytete në rrethin e Malësisë së Madhe (zona e Bajzës) në rrethin e Matit (zona e Klosit) dhe rrethin e Mirditës (zona e Rrëshenit). Marrëveshja parashikon që tani për tani uji i pijshëm të furnizojë linjat kryesore dhe institucionet për çdo fshat dhe, në perspektivë, parashikohet që të bëhen lidhjet nga linjat kryesore për

shtëpitë dhe konsumatorët e veçantë. Ndërtimi do të zgjasë 18 muaj, ndërsa periudha e mbikëqyrjes së funksionimit të tyre pas ndërtimit do të jetë 12 muaj. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.7.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35 të vitit 2001, faqe 1087. Bashkëlidhet Amendamenti për Marrëveshjen e Huasë.

**Ligj nr.8801, datë 17.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë me “ELBER” shpk dhe KFW për projektin dhe huanë për ndërmarrjen e ujësjellës-kanalizimeve në Elbasan”.** Marrëveshja e ratifikuar ndërmjet Republikës së Shqipërisë me “ELBER” shpk dhe KfW siguron për Ndërmarrjen e Ujësjellës-kanalizimeve në Elbasan një hua prej 23 500 000 Marka Gjermane. Marrëveshja përmban shumën dhe qëllimin e huasë, shpërndarjen e huasë Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit, disbursimin, shlyerjen, interesin dhe detyrimet e angazhimit, shlyerjen e parakohshme dhe pezullimin e disbursimeve, kostot dhe shpenzimet publike, si dhe disa kushte. Huaja do t’i transferohet e plotë Kompanisë së Ekzekutimit të Projektit në përputhje me kushtet e parashikuara në Marrëveshje dhe Kompania duhet ta përdorë huanë ekskluzivisht për “promovimin e zhvillimit ekonomik nëpërmjet investimeve në infrastrukturën e komunës Elbasan-Kanalizimi dhe Furnizimi me ujë – Elbasan” (“Projekti”). Kjo hua do të shlyhet deri më 30.12.2040 duke u paguar në 60 transhe. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.7.2002. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35 të vitit 2001, në faqen 1091. Bashkëlidhet Marrëveshja e Projektit dhe e Huasë.

**Ligji nr.8802, datë 17.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes No.ABA-R1-2-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga Marrëveshja e Huasë No.ABA-P1 e datës 28 nëntor 1995 ndërmjet Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.** Sipas Marrëveshjes së Huasë

ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare të lidhur më 28 nëntor 1995, huadhënësi i ka dhënë huamarrësit 1.681.000.000 jenë japonezë. Marrëveshja është garantuar dhe nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me garancinë për huanë më datën 22 nëntor 1995. Me Marrëveshjen e lartpërmendur Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare kanë rënë dakord të bëjnë disa ndryshime lidhur me termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me pagesën e interesit për huanë No.ABA-P1 të datës 28.11.1995 (Marrëveshja origjinale), duke përcaktuar që huamarrësi do t'i paguajë huadhënësit 5.088.001 jenë, që përfaqëson shumën e përgjithshme të interesit. Kjo shumë do të paguhet në dhjetë këste të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar ng data 30 qershor 2001. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.7.2001. Është botuar në Fletoren Zyrtare nr.35 të vitit 2001, në faqen 1098. Bashkëlidhet Marrëveshja dhe Garancia për shlyerjen e borxheve.

**Ligj nr.8803, datë 17.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes No.ABA-R1-1-D për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga Marrëveshja e huasë No.ABA-C1 e datës 11 maj 1994 ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar”.** Më datën 22 mars 2001 është lidhur Marrëveshja për shtyrjen e borxheve që rrjedhin nga Marrëveshja e Huasë No.ABA-C1, datë 11 maj 1994 ndërmjet Bankës Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë. Kjo Marrëveshje u lidh pas shkëmbimit të notave midis Qeverisë së Japonisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë më datën 23 nëntor 2000, lidhur me masat për lehtësimin e borxhit. Sipas kësaj, Banka Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Qeveria e Republikës së Shqipërisë kanë rënë dakord të kryejnë ndryshime në termat dhe kushtet që kanë të bëjnë me pagesën e interesit për huanë e datës 11 maj 1994. Shuma e përgjithshme e interesit

(që nuk është paguar) është 21.854.384 jenë dhe është pranuar të paguhet në 10 këste të barabarta e të njëpasnjëshme gjashtëmujore, duke filluar nga 30 qershor 2001. Pjesë të Marrëveshjes janë edhe Aneksi 1 (Përbërja e shumave të shtyra) dhe Aneksi 2 (kalendari i pagesës së shumës së shtyrë dhe kalendari i pagesave të interesit për shumën e riskeduluar.) Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 3.7.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35, faqe 1102. Bashkëlidhet Marrëveshja.

**Ligj nr.8804, datë 17.5.2001 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së shoqërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës kombëtare Elbasan-Librazhd”.** Me këtë Marrëveshje Huaje, ndihmohet huamarrësi të zbatojë një program për riparimin, rehabilitimin dhe sigurimin e përmirësimit të 30.5 km në rrugën Lindje-Perëndim, korridori Elbasan-Librazhd, për të përmirësuar transportin rrugor që lidh territorin e Huamarrësit me Republikën e ish-Jugosllavisë, të Maqedonisë dhe Greqinë, të ulë vonesat në lëvizjen e mallrave e të ndihmave për në kufirin e Maqedonisë, për të ndihmuar në rindërtimin e Kosovës. Kjo hua do të jetë në masën 10 000 000 Euro dhe do të shlyhet deri më 18 dhjetor 2014. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 03.07.2001. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.35 të vitit 2001, faqe 1106. Bashkëlidhet Marrëveshja e Huasë.

## Integrimi europian: Pse, çfarë dhe si?

*David Landsman*

*Ambasador i Britanisë së Madhe*

*(Fjalim i mbajtur në Forumin Shqiptar  
më 9 Maj 2002 në Shkodër)*

Duket me vend që po flasim sot për integrimin europian pikërisht këtu në Shkodër. Shkodra është një nga qendrat e Europës së vjetër, një udhëkryq i tregtisë dhe qytetërimeve, e cila si shumë të tjerë u izolua për një kohë tepër të gjatë nga rrjedha e zhvillimeve europiane, duke i lënë qytetarët e saj dhe institucionet si ky universitet të privuar nga kontakti me Europën, me të cilin ata mund të ecnin përpara. Por tani, në perspektivën e krijimit të një Europe të re, të integruar, Shkodra bashkë me pjesën tjetër të Shqipërisë mund të aspirojnë përsëri për të rifituar vendin e merituar si një qendër europiane.

Sot dua të flas për Europën e re e të integruar. Do të përpiqem të jap disa përgjigje për tri pyetjet e mëdha: “Pse të integrohemi?”, “Çfarë është integrimi aktualisht” dhe “Si mund të arrihet?” Këtyre pyetjeve duhet t’u jap një përgjigje moderne britanike: një përgjigje që thekson vizionin tonë për një të ardhme europiane, por që nuk injoron çështjet reale praktike dhe problemet.

Atëherë, para së gjithash, pse të integrohemi? Sigurisht, përgjigjja e parë është thjesht se në botën moderne të komunikimit të menjëhershëm dhe globalizmit nuk kemi zgjidhje tjetër përveçse të punojmë së bashku. (Siç e thashë, nevoja për një afrim europian duket se është një mësim, që të lashtët tuaj në Shkodër e mësuuan shumë kohë më parë).



Problemet e botës moderne: zhvillimi ekonomik, mbrojtja e mjedisit, krimi i organizuar, terrorizmi nuk mund të zgjidhen nga vendet në mënyrë individuale. Ndotja e mjedisit nuk pyet për kufij, kriminelët e organizuar rrallë shqetësohen për dallime etnike, prandaj qeveritë dhe institucionet duhet të punojnë së bashku nëse duan t'i zgjidhin këto probleme për të mirën e njerëzve.

Për më tepër ndodh shpesh që alternativa e bashkëpunimit të jetë konflikti. Bashkimi Europian u krijua mbi bazën e parimit që vendet e Europës Perëndimore, fillimisht Franca dhe Gjermania, pastaj edhe të tjerat përfshi Britaninë, nuk do të shkonin më në luftë me njëri-tjetrin. BE-ja filloi të ecë me hapa modestë, duke filluar me Komunitetin Europian për Qymyrin dhe Çelikun dhe me marrëveshje që mbulonin një fushë të vogël. Por ndërsa integrimi zhvillohet, kufijtë humbin pak nga kuptimi i tyre dhe njerëzit në të gjitha fushat punojnë bashkë gjithnjë e më afër. Kështu, edhe mundësia që këto vende të hyjnë në luftë zvogëlohet akoma më shumë.

Ky parim mund të zbatohet me lehtësi edhe në Europën Juglindore. Çfarë e dallon Ballkanin e vitit 2002 nga Ballkani i 1992-shit është sigurisht fakti që sot diktatorët e mëdhenj janë rrëzuar nga pushteti dhe nuk ka luftë. Por, gjithashtu, në 2002-shin ka një vizion real të ofruar për integrim europian, i cili edhe nëse ekzistonte në 1992-shin, nuk ishte formuluar siç duhej dhe prandaj nuk hapte rrugë dhe nuk i bindi njerëzit e rajonit. Retrospektiva nuk vlen shumë, por është interesante të pyesësh nëse po të ishte ofruar ky vizion dhjetë vjet më parë, ndoshta shkatërrimi i luftës në ish—Jugosllavi, përfshi dhe Kosovën, mund të ishte shmangur ose të paktën zbutur. Çfarë vlen tani është se mundësia për integrim është realitet. Kur vendet e rajonit të lidhen me njëri-tjetrin, siç janë lidhur vendi im me, të themi, Gjermaninë, Francën dhe Italinë, unë mendoj se është e qartë që të gjithë njerëzit e këtij rajoni do të bëjnë një gjumë më të qetë në shtëpitë e tyre. Asnjë vend i rajonit nuk e ndan më shumë këtë pikëpamje se sa Shqipëria. Përkrahja për integrimin euro-atlantik është pothuaj 100 për qind, aq sa mund të shpresojmë

ne në një demokraci, dhe nuk ka asnjë në Shqipëri që dëshiron një alternativë tjetër. Ne në Britani dhe BE e presim shumë mirë këtë. Ka edhe një argument tjetër në favor të integritit europian. Siç do të vazhdoj të diskutoj më vonë, integrimi europian është thjesht i pamundur pa përafrimin thelbësor të të gjitha fushave të jetës publike, politike dhe ekonomike. Përafrim do të thotë reforma. Radha e reformave nuk është një lloj ekzaminimi abstrakt, vendosur nga Bashkimi Europian me qëllim që t'i mbajë vende si Shqipëria jashtë, por më tepër reflekton parimet e një shoqërie moderne, demokratike, liberale dhe të hapur. Këto reforma ofrojnë mundësinë e një begatie afatgjatë, demokraci dhe siguri për qytetarët e Shqipërisë si në Europë. Kryeministri Majko tha se Shqipëria nuk duhet të bëjë reforma vetëm për t'u kualifikuar për integrim në Europë, por sepse këto reforma janë të mira për Shqipërinë. Shumë e drejtë, por nëse oferta për integrim europian mund të japë një nxitje për këto reforma, që (siç do ta them më vonë) nuk janë të lehta, atëherë Europa mund të luajë edhe një rol tjetër shumë pozitiv e jetik.

### **Pse duhet të integrohemi?**

Dua të filloj me dy mendime shumë të ndryshme mbi këtë çështje. Mbjaj mend, në vitin 2000, jo shumë kilometra larg prej këtu, në Podgoricë të Malit të Zi, shoqëroja një grup deputetësh britanikë që ishin aty për një vizitë zyrtare. Pas takimeve me politikanë, shkuam të takojmë një grup studentësh të anglishtesh. Studentët shpjeguan se një nga arsytet që ata mësonin gjuhën ishin për t'u bërë "pjesë e Europës". Atëherë deputetët pyetën pse ata donin të ishin "pjesë e Europës". Përgjigjja e tyre - kujtoni se ishte viti 2000 - ishte e thjeshtë: "Jo më bomba dhe jo më viza!". Unë e kuptoj këtë përgjigje, ka diçka të vërtetë në të: integrimi europian çimenton paqen, jep të drejtën për të udhëtuar lirshëm, por është larg nga e vërteta e plotë, sidomos puna e vështirë për reforma të brendshme, që shkojnë me integrimin europian. Prandaj mendimi im i dytë është ky. Ju mund të keni dëgjuar që Britania është në njëfarë mënyre e ndryshme nga pjesa tjetër e Europës dhe në

njëfarë mënyre jo pjesë e saj. Mirë, sigurisht ne kemi historinë tonë dhe pikëpamjet tona të veçanta, por unë ju siguroj se ne jemi anëtar i plotë dhe aktiv i Bashkimit European. Dhe ky është çelësi i pothuaj çdo aspekti të jetës politike, çdo ministri, shërbim publik, çdo vizitë nëpër dyqane, kushtet e punës së punëtorëve, janë në njëfarë mënyre të prekura dhe të ndryshuara nga anëtarësia jonë në BE. Ne nuk jemi anëtarë të BE-së thjesht sepse Toni Blair ndjek samite dhe nënshkruan deklaratat, por sepse deklaratat, ligjet dhe direktivat bëhen pjesë e plotë e jetës publike britanike. Dhe nuk ka dyshim se si rezultat ndryshimet kanë ndodhur për mirë.

Kështu, nga njëra anë integrimi europian ka të bëjë me një deklaratë politike që shpreh qëndrimin e një vendi. Por është edhe esencialisht një proces që sjell të gjitha aspektet e jetës publike në standarde të caktuara.

Hapi tjetër i procesit të integrimit: Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit  
Procesi i Stabilizim-Asociimit u konfirmua në Samitin e Zagrebit në nëntor 2000, qëllimi i të cilit ishte që BE-ja dhe vendet e rajonit të binin dakord për një rrugë progresive drejt integrimit europian.

MSA-ja në vetvete është një kontratë formale midis BE-së dhe një vendi, që shtron rrugën për një kandidaturre të mundshme anëtarësimi, duke angazhuar të dyja palët në aksione konkrete, reforma, përafrim ligjesh, bashkëpunim rajonal, asistencë teknike.

Lojtari kryesor për BE-në është Komisioni European. Komisioni në fillim bën një raport mbi përgatitjen e një vendi për një MSA dhe pastaj jep mandatin për negociatat. Në çdo fazë vendimi final merret nga Këshilli European që përfaqëson qeveritë e 15 vendeve anëtare. Edhe Parlamenti European duhet të japë miratimin për hapjen e negociatave. Dhe që marrëveshja të hyjë në fuqi, parlamentet e 15 vendeve, dhe pastaj përsëri Parlamenti European, duhet ta ratifikojnë atë.

Nga leximi i shtypit ju mund të mendoni se hapja e negociatave, nënshkrimi i marrëveshjes dhe zbatimi i saj janë e njëjta gjë ose ndodhin në

të njëjtën ditë. Por nuk është kështu. Negociatat do të hapen kur Këshilli të besojë se Shqipëria është gati. Të dyja palët, Komisioni dhe Qeveria Shqiptare do të punojnë pastaj mbi tekstin, do të bien dakord mbi afate dhe objektiva realiste dhe të pranueshme. Në të njëjtën kohë, BE-ja nëpërmjet programit CARDS dhe asistencës bilaterale të vazhdueshme nga vende si Britania, do të japë asistencë dhe përkrahje në shumë fusha, ndërsa Qeveria e Shqipërisë duhet të vazhdojë pandërprerje me zbatimin e reformave. Kur negociatat të përfundojnë dhe të bëhet ratifikimi, marrëveshja duhet të zbatohet në çdo hollësi nga të dyja palët për shumë vjet me radhë. Por ky nuk është një proces “o të gjitha, o asgjë”: ndërsa marrëveshja zbatohet, përfitimet do të vijnë gradualisht. Ju do të keni dëgjuar mbi propozimin e Britanisë dhe të vendeve të tjera të BE-së, që hapja e negociatave duhet të lidhet me progresin në reforma thelbësore. Ne nuk po ndryshojmë bazat mbi të cilat u ndërtua në fillim ftesa. Ne thjesht kërkojmë që reformat, që janë premtuar më parë, të zbatohen ose të jenë në rrugë të mbarë. Kjo është e rëndësishme për të dyja palët, me qëllim që të ruajmë besueshmërinë e këtij procesi. Integrimi evropian është si ndërtimi i një shtëpie: nëse nuk hedh mirë themelet, struktura do të rrëzohet. Dhe kjo është një garanci për popullin shqiptar, që angazhimet e marra nga Qeveria në emër të tyre, do të kthehen në reforma konkrete, nga të cilat ata do të përfitojnë. Unë jam i gëzuar që Qeveria ka theksuar vazhdimisht që procesi i MSA-së nuk është vetëm një çështje për Qeverinë, por për të gjithë vendin, duke përfshirë shoqërinë civile, të përfaqësuar për shembull, nga Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare. Ne besojnë që kjo është një pikë thelbësore.

Qëllimi i një Europe pa kufij aktualisht bëhet realitet vetëm nëse vendet mirëkuptojnë rregullat e lojës, zbatimin e ligjit, pavarësisht nëse flasim për krimin e organizuar ose mbrojtjen e investimeve ose etiketimin e një pakoje biskotash, dhe nëse vendet janë gati të zbatojnë rregullat sinqerisht dhe në bashkëpunim. Ndihmesa e Shqipërisë në bashkëpunimin rajonal është një shembull i shkëlqyer.

Pikërisht sepse procesi i Stabilizim-Asociimit është serioz, i aftë të sjellë ndryshime serioze, Britania ka qenë një ndër vendet e BE-së, që kanë shprehur shqetësim për procesin e reformave në Shqipëri: a po ecin ato me shpejtësinë e duhur dhe a janë aq të thella sa duhen, për t'i siguruar Shqipërisë një vend në Europën e bashkuar? Troç, ne nuk besojmë se është as në interes të Shqipërisë, as në interes të BE-së, që të pretendojmë që integrimi mund të ecë më shpejt sesa procesi i reformave në vend. Ne përkrahim zbatimin e rreptë të standardeve të BE-së, sepse sinqerisht mendojmë që ato do të ndihmojnë Shqipërinë të reformohet dhe të përparojë më shpejt drejt Bashkimit European.

Ne dimë që Shqipëria ka bërë përparim të madh në këto vitet e fundit dhe ka fituar diçka nga ajo që humbi gjatë viteve '90. Ne pranojmë që mosmarrëveshjet politike, brenda dhe midis partive, janë pjesë e thelbit të demokracisë. Ne njohim dhe mirëpresim faktin që këto mosmarrëveshje kanë ndodhur brenda Kushtetutës dhe pa provokuar prishje të rendit publik.

Por, nëse mund të përdor një metaforë nga futbollit anglez, kjo mund të mjaftojë për të pasur një vend në kategorinë e dytë, por nuk mjafton për një vend që me të drejtë aspiron për kategorinë e parë (Premier League). Si çdo njeri, edhe unë dua t'i shoh politikanët të luajnë bashkë e jo të luftojnë kundër njëri-tjetrit. Ne mirëpresim punën konstruktive të bërë nga OSBE-ja në këtë fushë, veçanërisht përpjekjet e saj për të arritur një marrëveshje për çështjen e zgjedhjeve. Por, më falni nëse unë nuk entuziazmohem shumë, duke parë drejtuesit e politikës duke bërë pakte dhe marrëveshje. Kjo është punë e tyre dhe, si i huaj, unë nuk dua të ndërhyj. Si përfaqësues i një vendi të Bashkimit European, që dëshiron të ndihmojë Shqipërinë të bashkohet me ne, ajo që më intereson është të shoh marrëveshjet politike të përkthehen në mbështetje reale për reforma konkrete.

Ja pse ne duhet të mendohe mi me kujdes se çfarë duam të themi me “stabilitet” si një parakusht për integrim. Nuk do të thotë thjesht të mbash një shoqëri urtë dhe në vend numëro, në një botë ku pak kanë atë çfarë duan

dhe të tjerët kanë fare pak perspektiva. Siç e pamë në Kosovë dhe Maqedoni, ai lloj “stabiliteti” nuk është i drejtë dhe nuk zgjat.

Por ka një pikë të përgjithshme këtu, që zbatohet njësoj në vende si Shqipëria, e cila për fat nuk ka konflikte etnike shkatërruese, të cilat dëmtuan keq shumicën e ish-Jugosllavisë. Stabiliteti modern duhet të jetë për drejtësinë dhe të drejtat e njeriut, dhe për një shtet që funksionon me transparencë në interes të të gjithëve. Kjo është ajo që sjell begatinë dhe sigurinë në vendet e Bashkimit European dhe është parakusht për integrim për ata që duan të bashkohen në të. Nuk ka rrugë tjetër.

Disa pesimistë thonë se Shqipëria nuk ka shanse për të arritur Europën, se Europa ecën përpara më shpejt sesa Shqipëria, se distanca midis të dyjave rritet e rritet e nuk zvogëlohet. Ne nuk jemi dakord. Europa e do Shqipërinë pjesë të saj. Ne nuk duam “vrime të zeza” në Ballkan. Por ne nuk mund ta pranojmë Shqipërinë ose këdo tjetër me çfarëdo çmimi. Ne duam ta shohim Shqipërinë të ecë përpara me hapat më të shpejta që mundet, duke vënë kushte të vështira, por jo të pamundura. Dhe ne duam të ndihmojmë. Vendi im ka investuar miliona paundë për stabilizimin e rajonit, në Kosovë, Maqedoni dhe Bosnjë. Dhe ndërsa kjo politikë ecën me sukses dhe prania ushtarake gradualisht ulet, ne duam të sigurojmë që investimi ynë është i sigurt për të ardhmen, duke ndihmuar me procesin e europianizimit.

### **Si mund të përparojë Shqipëria drejt integritit dhe si mund të ndihmojë Britania dhe Europa?**

Siç e kam thënë më parë, integrimi european është një vizion për të ardhmen. Është një vizion përmbledhës: ju e dini që nuk keni interes të qëndroni jashtë dhe ne nuk kemi interes që Shqipëria të qëndrojë jashtë. Por vizionet dhe deklaratimet politike nuk janë të mjaftueshme. Bashkimi European i shekullit të 21-të nuk është një aleancë midis familjeve mbretërore në sensin e shekullit të 18-të ose të 19-të, por një statut i vërtetë i shteteve, të gatshme për të bashkëvepruar për detaje të rëndësishme në pothuajse të gjitha aspektet e jetës publike.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që kanë ndodhur shumë zhvillime pozitive në pothuaj të gjithë sektorët, ministrinë, administrimin publik etj. Unë kam pasur kënaqësinë të takoj shumë njerëz, në ministri dhe në të tjera organizata publike, të cilët janë të mirinformuara për Europën dhe vendosën të çojnë organizatat e tyre në standarde më të larta.

Por, më shumë duhet të bëhet për t'i bindur udhëheqësit e BE-së, si dhe parlamentarët e popujt e tyre, që ekziston vullneti i politikës për të bërë ndryshimet e nevojshme. Ne po flasim aq shumë për "korrupsionin dhe krimin e organizuar", sa që rrezikon të kthehet në një parullë, ashtu si "prodhimi ekonomik" në periudhën e komunizmit.

Por ky problem është fundamental. Demokracia moderne varet shumë nga zbatimi i ligjeve, për t'u dhënë njerëzve mundësi, të drejta, për të mënjnauar diskriminimin dhe për të krijuar transparencë në jetën publike.

Sinqerisht, korrupsioni në Shqipëri – i izoluar brenda vendit – nuk e dëmton shumë Britaninë. Unë në çdo çast mund të mbyll Seksionin e Tregtisë në Ambasadën time dhe të këshilloj biznesmenët anglezë të shkojnë diku gjetkë. Por është ekonomia shqiptare dhe në veçanti shqiptarët e thjeshtë pa pushtet që vuajnë më shumë.

Krimi i organizuar është një çështje krejt tjetër. Ka plot evidenca që vendi im, si shumë vende të tjera në Europë, po vuan efektet e sëmura të krimit të organizuar dhe të trafikut, që kanë lidhje me shqiptarë. Ky është problem për ne dhe ju do të shihni që ne do ta trajtojmë si çështje me interes të lartë kombëtar.

Unë kam folur gjatë për kërkesat që ka procesi i integritimit. Por asnjë nuk pret që Shqipëria ose ndonjë vend tjetër në rajon, të përballojë këtë proces e vetme, pa asnjë ndihmë. Së pari, Britania ka qenë një nga të parët që ka kërkuar zgjerimin e Bashkimit Europian dhe për shtrirjen e përfitimeve të integritimit në të gjithë Ballkanin. Toni Bler ka luajtur një rol udhëheqës në bërjen e Europës më të hapur ndaj këtij rajoni si rezultat i përvojës së tij në krizën kosovare. Ai i besonte atëherë dhe vazhdon akoma të besojë, se

perspektiva për integrim europian është shpresa më e mirë për një Ballkan në paqe dhe begati në të ardhmen. Angazhimi ynë politik mbetet, megjithëse unë duhet të theksoj se ne nuk mund të jemi më të angazhuar në integrimin e Shqipërisë sesa vetë Shqipëria.

Asistenca jonë shkon më shumë se kaq. Së pari, duhet vënë në dukje se ndihmesa e Britanisë për programet e asistencës për Shqipërinë në kuadrin e CARDS-it të Bashkimit Europian do të jetë 20 për qind i 140 milionë eurove të planifikuara për 3 vjetët e ardhshëm. Ky program do të mbulojë një asistencë të gjerë teknike për zhvillimin e institucioneve shqiptare, që ato të bëhen sa më moderne, përgjegjëse, demokratike dhe eficiente, të kompjuterizuara dhe, aty ku duhet, të lidhura me partnerët e tyre rajonale dhe europianë. Asistenca mbulon pothuajse çdo sferë të imagjinueshme, duke përfshirë tregtinë, ekonominë, ligjet dhe rregullat, bujqësinë, mjedisin dhe kështu me radhë. Mbase e vetmja fushë e mbetur jashtë është reforma ushtarake, për të cilën NATO-ja ka një program të krahasueshëm të përbashkët me Shqipërinë.

Por përveç kësaj, Britania ka programin e saj dypalësh të asistencës teknike, momentalisht, në vlerën 5 milionë në vit, që për çastin mbulon politikën ekonomike dhe taksat, shëndetësinë dhe shërbimet sociale, si dhe ekonominë rurale dhe mjedisin. Jam i kënaqur t'ju them se në shumicën e fushave, bashkëpunimi është shumë i lartë dhe progresi i arritur është shumë i mirë. Britania është, gjithashtu, kontribuesi kryesor i programeve të Institucioneve Ndërkombëtare të Financës dhe të Bankës Botërore. Megjithëse jo në kuadrin e Bashkimit Europian, implementimi me ndihmën e FMN-së dhe të Bankës Botërore i Strategjisë Qeveritare për Reduktimin e Varfërisë, e cila u përpilua me ndihmën e organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile shqiptare, është një aspekt jetësor i krijimit të kushteve ekonomike dhe sociale, të cilat do ta sjellin më afër Shqipërinë me mesataren europiane. Nëse të varfërit nuk përfitojnë, kjo do të thotë që projekti ka dështuar.

Seminari i sotëm është tamam shembulli se çfarë lloj nismash ne duam të mbështesim. Ka një nevojë jetike për më shumë informacion për Europën.



Kjo është dukur si ide e mirë deri tani, kur mundësia për të lëvizur drejt Europës është dukur e largët. Por tani, kur procesi ka filluar me të vërtetë, detajet kanë filluar të shfaqen dhe të gjithë ata që duan të jenë kampionët e integritit të Shqipërisë duhet të fillojnë ta bëjnë çështjen më të fortë dhe më pozitive. Dhe midis këtyre kampionëve unë përfshij Britaninë dhe partnerët tanë në Bashkimin Europian, Qeverinë Shqiptare, organizata civile, si për shembull Instituti Shqiptar për Studime Ndërkombëtare dhe besoj të gjithë ju që jeni sot këtu.

Në muajt e ardhshëm, Ambasada Britanike së bashku me partnerët tanë shqiptarë, do të marrim përsipër këtë sfidë dhe do të bëjmë sa të mundemi që mesazhi nga Europa të arrijë i fortë dhe i qartë.

## **Bashkëpunimi ndërparlamentar në kuadrin e Paktit të Stabilitetit**

*Përgatiti Elira Zaka  
Koordinatorë Qendra e  
Studimeve Parlamentare*

Pakti i Stabilitetit është përpjekja e parë serioze e komunitetit ndërkombëtar për të zëvendësuar politikën e mëparshme të ndërhyrjes reaguese ndaj krizave në Europën Jug-Lindore me një strategji parandaluese afatgjatë dhe gjithëpërfshirëse. Më 10 qershor 1999, me iniciativën e Komunitetit European u adaptua, në Cologne, Pakti i Stabilitetit për Europën Jug-Lindore. Në dokumentin themeltar më shumë se 40 vende dhe organizata partnere morën përsipër forcimin e vendeve të Europës Jug-Lindore “në përpjekjet e tyre për nxitjen e paqes, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimit ekonomik, për të arritur stabilitetin në të gjithë rajonin ». U premtua integrimi Euro-Atlantik i të gjitha vendeve të rajonit. Në summit-in e Sarajevës, më 30 qershor 1999, Pakti u riafirmua.

Ideja e Paktit të Stabilitetit u hodh në fund të vitit 1998, dhe në këtë kuptim ajo parapriu luftën e Kosovës. Por ndërhyrja e NATO-s në Kosovë padyshim që veprroi si një katalizator në forcimin e vullnetit politik ndërkombëtar për një veprim të koordinuar dhe parandalues në rajon.

Pakti i Stabilitetit bazohet në eksperiencat dhe mësimet kryesore të menaxhimit të krizave ndërkombëtare mbarëbotërore. Parandalimi i konfliktit dhe ndërtimi i paqes mund të jenë të suksesshme vetëm nëse ato nisin në mënyrë paralele në tri sektorë kyç: krijimi i një mjedisi të sigurtë, promovimi i një sistemi të qëndrueshëm demokratik, dhe i mirëqënies ekonomike dhe

VEPRIMTARI TË ORGANIZMAVE NËRËKOMBËTARE

sociale. Vetëm nëse do të ketë progres në të tri sektorët, mund të arrihet në një proces paqeje të qëndrueshme.

Pakti i Stabilitetit është një deklaratë politike e angazhimit, dhe një marrëveshje për bashkëpunim ndërkombëtar, për zhvillimin e një strategjie të ndarë midis partnerësh për stabilitet dhe zhvillim në Europën Jug-Lindore. Pakti i Stabilitetit nuk është një organizatë e re ndërkombëtare dhe as nuk ka struktura të pavarura burimesh financiare dhe zbatuese..

Nga ana organizative, Pakti i Stabilitetit i referohet Koordinatorit Social, Erhard Busek, dhe ekipit të tij prej 30 vetësh. Detyra e tij më e rëndësishme është të sjellë në një linjë strategjitë politike të pjesëmarrësve, të koordinojë iniciativat ekzistuese dhe të reja në rajon, dhe, në këtë mënyrë, të shmangë duplikimin e panevojshëm të punës. Zyrat qendrore të Koordinatorit Special ndodhen në Bruksel.

Koordinatori Special kryeson instrumentin më të rëndësishëm politik të Paktit të Stabilitetit, Tryeza Rajonale. Në Tryezën Rajonale operojnë tri Tryeza Pune:

- Tryeza e Punës I: Demokratizimi dhe Të Drejtat e Njeriut
- Tryeza e Punës II: Rindërtimi ekonomik, Bashkëpunim dhe Zhvillimi;
- Tryeza e Punës III: Cështjet e Sigurisë (me dy nën tryeza: Siguria dhe Mbrojtja, dhe Drejtësia dhe Punët e Brendshme)

Në mbledhjen e parë rajonale të Tryezës së Punës mbi Demokratizimin dhe Të Drejtat e Njeriut, në tetor 1999 në Gjenevë, u krijuan disa task forca, ndër të cilat *Task Forca mbi Bashkëpunimin Parlamentar*.

Qëllimi i *Task Forcës së Bashkëpunimit Parlamentar* është promovimi i demokracisë, duke forcuar rolin e parlamenteve në Europën Juglindore dhe kontributin e tyre për stabilitet në rajon, nëpërmjet rritjes së bashkëpunimit midis tyre. U konsiderua si i nevojshëm inkurajimi dhe përmirësimi i aktivitetit të parlamenteve në procedurën për prezantimin e legjislacionit të nevojshëm, për krijimin e institucioneve të forta demokratike,

mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve si dhe vendosjen e një baze solide ligjore për një ekonomi të shëndetshme.

Në Tryezën e Punës së Paktit të Stabilitetit mbi Demokratizimin dhe të Drejtat e Njeriut, *Task Forca mbi Bashkëpunimin Parlamentar ka objektivat e mëposhtëm:*

1. Forcimi i efektivitetit demokratik dhe parlamentar në Europën Juglindore.

2. Promovimi i bashkëpunimit bilateral dhe multilateral midis parlamenteve në Europën Juglindore.

3. Kontribuimi në sjelljen më afër Bashkimit Europjan të vendeve të rajonit, të cilat nuk janë ende kandidatë për pranim.

Pjesëmarrja në Task Forcën mbi Bashkëpunimin Parlamentar përfshin asamblatë parlamentare ndërkombëtare, parlamentet kombëtare gjithashtu, si dhe katër OJQ-të që siguroan financimin e nevojshëm në Paketën e Shpejtë të Nisjes të miratuar nga Konferenca Rajonale e Financimit në Bruksel, 29-30 mars 2000.

Që prej vitit 1998, parlamentarë nga Europa Juglindore mbledhen së bashku me kolegët e tyre të Parlamentit Europian dhe të parlamenteve kombëtare të vendeve të tjera të Europës.

Interesi për bashkëpunimin parlamentar në kuadrin e Paktit të Stabilitetit erdhi në mënyrë spontane nga asamblatë ndërkombëtare, si ajo e Parlamentit Europian dhe Asamblatë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe OSBE. Në nëntor 1999, ato afirmuan në Sofie edhe një herë rëndësinë e debatit parlamentar, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, në procesin e zbatimit të Paktit të Stabilitetit. Kjo deklaratë u riafirmua pothuaj një vit më vonë, në shtator 2000, në Zagreb. Për më tej, ato inkurajuan parlamentet europiane juglindore për vendosjen e nën-komiteteve speciale parlamentare apo grupeve ad-hoc për çështjet që lidhen me Paktin e Stabilitetit. Në përgjigje të konkluzioneve nga mbledhje të ndryshme parlamentare, në veçanti të Konferencës Parlamentare të Sofies dhe samitit parlamentar të Zagrebit,

Koordinatori Special i Paktit të Stabilitetit propozoi, në fund të shtatorit 2000, që Parlamenti European, Asambletë Parlamentare të Këshillit të Europës dhe OSBE të bëhen sponsorë të *Task Forcës për Bashkëpunimin Parlamentar*. Tri asambltë ishin angazhuar në troika bashkëpunimi edhe në raste të tilla të mëparshme. Së bashku, ato përfaqësojnë dimensionin e Bashkimit European dhe parlamentet kombëtare të Europës. Me qëllim që të sigurojë që Task Forca zbaton një strategji që i përshtatet objektivave të përgjithshme të Paktit të Stabilitetit, u vendos një sistem sponsorizimi Troika, në qershor 2001. Ky zhvillim shënoi fillimin e lidhjeve të vërteta institucionale parlamentare midis Paktit të Stabilitetit, institucioneve parlamentare ndërkombëtare dhe parlamenteve kombëtare në vendet pjesëmarrëse. Parlamenti European dhe Asambletë Parlamentare të Këshillit të Europës si dhe OSBE, secila prej tyre merr drejtimin me rotacion në çdo 6 muaj.

Roli i Troikës është t'i japë drejtim politik Task Forcës, si dhe të ndihmojë në krijimin e një kornize koherente për aktivitetet që organizohen në kontekstin e Task Forcës. Troika vendos në konsultim me Koordinatorin Special mbi evenimentet e mëdha që mbahen.

Në Mbledhjen Rajonale të Tryezës së Punës 1 në Portoroz (Maj 2001) u ra dakort që dimensionin parlamentar nuk duhet të mbyllet me Tryezën e Punës I, por parlamentarët duhet të përfshihen në punën e të tri tryezave të Paktit të Stabilitetit, si dhe në Tryezën Rajonale.

Gjatë drejtimit 6-mujor, secila nga drejtueset e radhës të Troikës organizon një veprimtari me përmasa të rëndësishme, në bashkëpunim me një ose disa nga katër OJQ-të e sipërpërmendura.

Aktivitetet e sponsorizuara nga Troika shërbejnë si një forum politik për diskutimin e çështjeve të Paktit të Stabilitetit që lidhen jo vetëm me Tryezën e Punës mbi demokratizimin dhe të drejtat e njeriut, por, gjithashtu, edhe me infrastrukturën sociale dhe ekonomike, si dhe mbrojtjen e sigurinë.

Nisma e parë e Parlamentit European ishte Konferenca Parlamentare e BE dhe vendeve të Paktit të Stabilitetit, zhvilluar në Bruksel, në shtator

2001. Ajo provoi se çështjet kyçe, të tilla si vendosja e ligjit, rindërtimi ekonomik dhe lufta kundër krimit të organizuar, mund të gjejnë një platformë të përbashkët për debat në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Përfaqësuesit u inkurajuan të nxisin qeveritë e tyre për të komplementuar vullnetin politik me mbështetjen publike për reforma. U bë thirrje, gjithashtu, për mbështetje financiare në disa fusha, si p.sh., në kthimin e refugjatëve, trafikun e qënieve njerëzore dhe krijimin e një klime favorizuese për investime. Anëtarët e parlamenteve kombëtare u ftuan të krijojnë strukturat ad hoc parlamentare, si grupet e punës dhe komitetet speciale, dhe të krijojnë një bashkëveprim rajonal nëpërmjet bashkëpunimit në rrjetet rajonale.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës ka marrë përsipër rolin drejtues të Troikës që nga 7 korriku i vitit 2002 dhe në vjeshtë ajo do të organizojë Konferencën Parlamentare mbi aspekte ekonomike të Paktit të Stabilitetit.

### **SEKRETARIATI EKZEKUTIV**

Një Sekretariat Ekzekutiv, i marrë përsipër nga Instituti Ndërkombëtar për Demokraci me qendër në Strasburg, asiston Troikën për zbatimin e strategjisë së Paktit të Stabilitetit. Detyra e tij është të mbledhë dhe të shpërndajë informacion mbi aktivitetet e kryera në këtë kuadër nga parlamentet kombëtare, qofshin këto bilaterale apo shumëlaterale, si dhe të asambleve ndërkombëtare parlamentare në kuadrin e Paktit të Stabilitetit. Për këtë qëllim u krijua një database për regjistrimin e të gjitha aktiviteteve të kryera nga OJQ-të dhe fondacionet, si dhe për shmangien e dublikimit të tyre.

Task Forca prodhon një gazetë elektronike tre-mujore për shkëmbimin e informacionit dhe opinioneve mbi evenimente dhe aktivitete të shkuara, në proces dhe të ardhshme, të lidhura me punën e saj. Pjesëmarrësit janë ftuar të kontribuojnë me raporte, ndërsa një website i ngritur për këtë qëllim (<http://www.iidemocracy.coe.int>) është lidhur me site dhe burime të tjera interneti relevante me punën e Task Forcës dhe pjesëmarrësve të saj.

## Information on laws passed by Assembly

*Filip Lako*  
*Lawyer*

**Law No.8788, dated 7 May 2000 “On the non-profit organizations”.** This law lays down the rules for the foundation, registration, functioning, organization and activity of the non-profit organizations, which aim at public interest and benefit. The founding, forms, organization, functioning and the area of activity of the non-profit organizations are carried out in accordance with the Civil Code and the above mentioned law. According to the general principals of the law, each natural person or legal person, national or foreigner, has the right to found a non-profit organization, to be a member of it or to participate in the leading organs or in the administrative staff of the non-profit organization. The law makes the division of the non-profit organizations according to the organization and to the right, gives the way of their founding and registration, organization and functioning, the rights of foreign non-profit organizations, defining the necessary documentation needed for the registration etc. The problems related to the license granting, the incomes from the economical activity, as well as those related to the transformation, reunion, interruption of the activity and the dispersion of the non-profit organizations are also settled in the law. The Law No. 7695, dated 7 April 1993 “About the foundations” has been abrogated. The law has 52 articles and has entered into force on 22 June 2001. It is published in the Official Gazette No. 28, page 857, and year 2001.

**Law No. 8789, dated 7 May 2001 “For the registration of the non-profit organization”.** This law defines the procedures of the registration of the non-profit organizations, as well as the rules for their register keeping. It regulates the problems related to the activity of the Register Secretary, with the publication of the legal announcements etc. There are given in a detailed way the form and the content of the register regarding the folders, file-cabinets, dates of registration, their change, correction etc. The decision for the registration of the non-profit organizations, as any other decision, regarding the activities related to their registration, are done by a judge of the commercial section of the tribunal. The Register of the non-profit organizations is kept from the Tirana District Court. The law has 41 articles and has entered into force in 22 June 2001. It is published in the Official Gazette No.28, year 2001, page 872.

**Law. no. 8790, dated 10 May 2001 “On some amendments and supplements of the law no. 7829, dated 1 June 1994 “On the notary”.** This law amends the articles 2,3,17 and the first paragraph of the article 16. In the article 6 several supplements amendments are done, whereas articles 2a, 3a have supplements, articles 8, 11, 12,15,26,35,49,54,65 and 71 have partial supplements. In all the articles of this law where the word “circle” is written, should be replaced with the word “juridical circle”. Important supplements are done to the article 2, regarding the conditions of becoming a notary as well as in the article 3 regarding the qualification. The amendments, especially those in the articles 2a, 3a, arrange the first one the problems related to the experience that the candidate should make to become a notary, and the second (article 3a) related to the assistance, namely about the work of the candidate for a notary near a notary assigned by the National Chamber of Notaries. Referring to this amendment, in the conclusion of the assisting period, the assistant is provided with the certificate



released by the Chamber of Notaries, after the evaluation by writing from the notary the assistant has been working with. The amendments and supplements done, make the existing law more accurate and clear. The law has 19 articles and has entered into force in 22 June 2001. It is published in the Official Gazette no.29, year 2001, page 889.

**Law no.8791, dated 10 May 2001 “ For the approval of “The agreement of the Concession form “ROT” of the Chrome Mining in Bulqiza, Milling Factory in Bulqiza, Selection Plant in Klos and the Ferrochrome Factory in Burrel between the Ministry of Public Economy and Privatization and the Association of Italian Right “Darfo” S.PAGEA, as well as the issuing of incentives and guaranties concerning the concessionaire of this Agreement””.** This agreement has as an object the legitimacy of issuing in concession the Chrome Mining in Bulqiza, the Milling Factory in Bulqiza, the Selection Plant in Klos and the Ferrochrome Factory in Burrel, Anex 1, that the Authorized State Body (OSHA), assigned by the Council of Ministers, accredited to the concessionaire in order to execute the rehabilitation, financing, administration and exploitation of this object. According to this law, the Concessionaire Association (trade) founded from the concessionaire party is excluded from the obligation of paying the customs and the VAT for the machinery, lines, equipment and other materials which will be used for investments for the 8-years investing time period. The law obliges the Council of Ministers to treat the obligations toward the state, social insurance and the third parties by the commercial association “ALBKROM” A.A., in Tirana for the objects issued for concession, since entering into force of the Concession Agreement. The law has 5 articles and entered into force in 22 May 2001. It is published in the Official Gazette no.29, year 2001, page 893. Enclosed is the Concession Agreement.

**Law no. 8792, dated 10 May 2001 “For the creation of the Data-Processing Center”.** This law establishes under the General Directorate of State Police the Data-Processing Center and defines rules for the regulation of the data’s computerized usage, which deal with the operative activities of the central and local offices of the State Police. The law regulates the organization of the centre, the, responsibilities and duties of the director and deputy director, preliminary conditions of data-entering, the preservation of data-entering process, the data’s and information transmission abroad, usage of information, the right for complaint, the creation of data bank etc. In the understanding of the law “the data bank is the ensemble of the data and information about persons and objects, organized according to some criteria, which facilitate their treatment and, in case of any communication or usage of data bank from any person who do not respect the obligation under this law, is sentenced with one to three years imprisonment. The law has 18 articles and has entered into force in 24 June 2001. It is published in the Official Gazette no.30, year 2001, page 909.

**Law no. 8793, dated 10 May 2001 “For the prescription of default interest of the unpaid social insurance contributions”.** By the above mentioned law all the state enterprises and trade associations with entirely state capital assets will not pay the default interests for the social insurance contribution unpaid until 31 December 2000. The law has 2 articles and has entered into force in 24 June 2001. It is published in the Official Gazette, no.30, year 2001, page 914.

**Law no.8794, dated 10 May 2001 “For some amendments in the law no.8410, dated 30 .09.1998 “On the public and private radio and television in the Republic of Albania”, amended by the law no. 8655, dated 31.07.2000”.** The law no.8410, dated 30.09.1998 “For the public and private radio and television in the Republic of Albania” has had

some very important supplements, either the law no.8655, dated 31.07.2000, or this law. Thus, the law no.8794, dated 10 May 2001 amends 10 articles, which are the articles 7,10,11,17,20,42,75,112 and 126 and some supplements are done in the articles 7,10,14,43,73,85,119,129,137 and the article 23 has been abrogated. The amendments deal basically with the administration of radio frequencies from National Council of Radio Television, sorts of licenses, dues for license acquirement and renovation, due to the organization and functioning of NCRT. The amendments deal with the competences of the Chairman of the National Council of Radio Television, with some provisions of the law on author's right and how should they apply for the law, while the sanctions for breaking the provisions of this law are increased etc. Furthermore, the link 1 which deals with the payment rate in a yearly basis for acquiring license for national and local radio and television is added to the law. The law has only one abrogation and this has been done for the clause 5 of the article 23. The law no.8794, dated 10.05.2001 has 21 articles and has entered into force on 30.06.2001. It is published in the Official Gazette no.34, year 2001.

**Law no.8795, dated 14.05.2001 “On the ratification of the Agreement between Export Credit Bank of Turkey and the Government of the Republic of Albania concerning the rescheduling of the debt”.** By means of this agreement, the Government of the Republic of Albania, represented by the Ministry of Finance of Albania and the Export Credit Bank of Turkey agree to reschedule the debt deriving from the Credit Agreement dated 1.02.1991. This agreement is undersigned between Turk Eximbank and the Bank of Albanian State for the International Relations. By this Rescheduling Agreement, the Government of the Republic of Albania to undertake all the financial commitment by 17,574,769 USD, deriving from the Credit Agreement and the Insurance Facility. The amount of

17.574.769.22 USD, rescheduled, is comprised of 13.865.328.3USD which is the unpaid amount of the principal, from 719.444.74 USD which is the amount of unpaid interest of Turk Eximbank for Insurance Facility. The amount of 17.574.769.22 USD will be paid by 21 consecutive six months-period installments. The law has 2 articles and has entered into force on 24 June 2001. It is published in the Official Gazette, no.30, year 2001, page 915.

**Law no.8799, dated 17.05.2001 “On the ratification of the Loan Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Islamic Bank of Development for the water system project and for the canalization in Fushë-Kruja and Peshkopi”.** The aim of this project is to improve the water system in the cities of Fushë-Kruja and Peshkopi through the enlargement of the water system and canalization as well as find of new water sources. The project includes public works, supervision of the services and consulting. Public works consist on the forms of extension of water system, canalization system, and construction of water tanks, chlorinating, pump stations, well perforation, supply and installation of water measuring instruments, and other public works. The loan will be an amount not larger then the equivalence of 4.990.000 Islamic Dinars, and the borrower will disburse the amount of the loan within 25 years. The law has 2 articles and has entered into force on 30.06.2001. It is published in the Official Gazette no.34, year 2001, page 1063. The Loan Agreement is attached.

**Law no. 8800, dated 17.05.2001 “For the ratification of the “Amendment on the Loan Agreement between the Government of the Republic of Albania and the Islamic Bank of Development on the water system project for the villages”.** The Agreement between

the Government of the Republic of Albania and the Islamic Bank of Development is done on 7.10.1996. By means of this law are also approved some amendments which have been done to this agreement, completing and specifying it properly. The amendments have been done to the partly payment tables and the services payment. In addition, amendments have been done to the project description, according to which 29 villages and three cities will be furnished with drinking water in the district of Malësi e Madhe (area of Bajza), in Mati district (area of Klos) and the district of Mirdita (area of Rrëshen). The agreement foresees that for the moment the main lines and institutions for each village will be furnished with drinking water, and in the future it is foreseen that linkages from the main lines with the houses and separate consumers will be realized. The construction phase will last 18 months, while the period of supervision of their operating after the construction will be 12 months. The law has 2 articles and has entered into force on 3.07.2001. It is published in the Official Gazette no.35, year 2001, page 1087. The Amendment of the Loan Agreement is attached.

**Law no.8801, dated 17.05.2001 “For the ratification of the Agreement between the Republic of Albania and “ELBER” ltd and KFW on the project and the loan for the enterprise of water system and canalization in Elbasan”.** The Agreement ratified between the Republic of Albania and “ELBER” ltd. and KFW provides a loan of 23 500 000 German Marks for the enterprise of water system and canalizations in Elbasan. The Agreement contains the amount and the purpose of the loan, the distribution of the loan to the Executing Company of the project, disbursing, liquidation, interest and the obligation of commitment, the early liquidation and the suspension of the disbursement, costs and public expenses, as well as some other conditions. The loan will be transferred in total to the Company of Execution of the project in accordance with the foreseen con-

ditions of the Agreement and the company should use the loan exclusively for “the promotion of the economic development through the investments in the infrastructure of Elbasan commune”. The law has 2 articles and has entered into force on 3.07.2002. It is published in the Official Gazette no.35, year 2001, page 1091. It is enclosed the Loan Agreement for the project.

**Law no.8802, dated 17.05.2001 “For the ratification of the Agreement No.ABA-R1-2-D for the liquidation of the debt deriving from the Loan Agreement No.ABA-P1 dated 28 November 1995, between the Albanian Electro- energetic Corporation and the Japanese Bank for International Cooperation”.** According to the Loan Agreement between the Japanese Bank for International Cooperation and the Albanian Electro-energetic Corporation, approved on 28 November 1995, the moneylender has given to the borrower 1.681.000.000 Japanese Jen. The Agreement is guaranteed and undersigned by the Government of the Republic of Albania along with the guarantee for the loan on 22 November 1995. The Japanese Bank for International Cooperation and the Albanian Electro-energetic Corporation have agreed to make some changes dealing with the terms and conditions related to the interest payment of the loan, dated 28 .11.1995 (original agreement), determining that the moneylender will pay to the borrower 5.088.001 Jen, amount that represents the total amount of interest. This amount will be paid in 10 equal consecutive 6-months installments, beginning from the date 30 June 2001. The law has 2 articles and has entered into force on 3.07.2001. It is published in the Official Gazette, no.35, year 2001, page 1098. It is enclosed the Agreement and the Guarantee for debt liquidation.

**Law no.8803, dated 17.05.2001 “For the ratification of the Agreement No.ABA-R1-1-D about debt liquidation, deriving from**

**the Loan Agreement No.ABA-C1, dated 11 May 1994 between the Government of the Republic of Albania and the Japanese Bank International Cooperation.** On 22 March 2001 has been approved the Agreement for the liquidation of debts deriving from the Loan Agreement No.ABA-C1, dated 11 May 1994 between the Japanese Bank for International Cooperation and the Government of the Republic of Albania. This Agreement was done after the exchange of notes between the Government of Japan and the Government of the Republic of Albania, on 23 November 2000, dealing with the debt facilitating measures. According to this, the Japanese Bank for International Cooperation and the Government of the Republic of Albania has agreed to make some changes in the terms and conditions for the interest payment regarding the loan of date 11 May 1994. The total amount of interest (which is not paid) is 21.854.384 Jen and it is agreed to be paid in 10 consecutive equal 6-months installments, beginning from 30 June 2001. Part of the Agreement is also Anex 1 (The composition of the liquidated amounts) and Anex 2 (the schedule of postponed payment and the schedule of interest's payment for the rescheduled amount) The law has 2 articles and has entered into force on 3.07.2001. It is published in the Official Gazette, nr.35, page 1102. It is enclosed the Agreement.

**Law no. 8804, dated 17.05.2001 “For the ratification of the Agreement between the European Bank for Reconstruction and Development on the project for rehabilitation of the national road Elbasan – Librazhd”.** By means of this loan Agreement, it is assisted the borrower to execute a program for the reparation, rehabilitation and ensuring the improvement of 30, 5 km on the way East-West, corridor Elbasan-Librazhd, in order to improve the road transport that links the territory of the borrower with the Ex-Yugoslav Republic of Macedonia and Greece, and to help in the reconstruction of Kosova. This loan will be 10 000 000 Euro and

will be liquidated until 18 December 2014. The law has 2 articles and has entered into force on 03.07.2001. It is published in the Official Gazette, no.35, year 2001, page 1106. It is enclosed the Loan Agreement.







Personat që janë të interesuar të abonohen në këtë Revistë, janë të lutur të kontaktojnë në adresën:

**Rruga “Sami Frashëri”, Pall.3/15,  
Pallatet e Aviacionit**

**☎: 04 240214,**

**e-mail: berberiscpdp@albaniaonline.net**

**Home page: www.ascpdp.org**

---

Botuesit e kësaj Reviste mirëpresin dhe e vlerësojnë si ndihmë çdo vërejtje apo sugjerim për përmirësimin e cilësisë së Revistës. Vërejtjet dhe sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në adresën e sipërpërmendur.

*Ju faleminderit!*

---

*Those who are interested to register are pleased to contact at:*

**Rruga “Sami Frashëri”, Pall.3/15,  
Pallatet e Aviacionit**

**☎: 04 240214,**

**e-mail: berberiscpdp@albaniaonline.net**

---

The editors welcome any suggestion or comment to improve the quality of the Review. You can send your comments and suggestions to the above mentioned address.

*Thank You!*

---

Kopertina: R&T Advertising

Art grafik: Elvira Çiraku

---

Shtypur në shtypshkronjën “ALB Paper”

---

**Drejtor i Revistës:** Sokol BERBERI

**Kryeredaktore:** Elira ZAKA

**Bordi editorial:** Filip LAKO  
Perikli ZAHARIA  
Leon SHESTANI  
Sokol BERBERI

**Përkthyes:** Elira ZAKA

**Redaktor:** Pandeli KOÇI

**©Copyright 2001:** Qendra e Studimeve Parlamentare

---

**Kjo revistë botohet me mbështetjen financiare të  
Ambasadës Britanike në Tiranë**

## Nr 8

### **Marrëdhëniet deputet zgjedhës: për një rritje të përfaqësimit dhe besimit tek institucionet**

- Roli përfaqësues
- Aspekte të komunikimit dhe etikës
- Zyrat e deputetëve
- Roli i shoqërisë civile në procesin legjislativ





